



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development



Komuna Deçan



GLV Gjeravica

Strategjia Zhvillimore Lokale

2024-2029

Qasja Leader



Deçan, Nëntor, 2024

Përmbajtja

DEKLARATA E KRYETARIT TË KOMUNËS SË DEÇANIT, Z. BASHKIM RAMOSAJ	..3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	..4
1. QËLLIMI I RISHIKIMIT TË STRATEGJISË	..6
1.1. Metodologjia për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal -Qasja Leader	6
2. PROFIL I SHKURTËR RRETH GLV "GJARAVICA" KOMUNA DEÇAN	..9
2.1. Bordi menaxhues	9
2.2. Strategjia e Zhvillimit Lokal -Qasja Leader 2024-2029	10
2.3. Takimi Informues	11
2.6. Organizimi i 5 punëtorëve me palët me interes	13
2.7. Organizimi i dy vizitave në GLV-të në Regjione të ndryshme	15
2.8. Organizimi i Seminarit përfundimtar në nivel lokal	16
3. DEFINIMI I ZONËS -PROFIL I SHKURTËR I KOMUNËS SË DEÇANIT	18
3.1. Zhvillimi demografik /Popullsia dhe zona/	18
3.2. Pozita Gjeografike:	18
3.3. Karakteristikat e hidrografisë	19
3.4. Zhvillimi Ekonomik	20
3.5. Turizmi	21
3.6. Trashëgimia natyrore	25
3.7. Trashëgimia kulturore	27
3.8. Bujqësia	28
4. SWOT ANALIZA LOKALE PËR ZHVILLIMIN RURAL NË KOMUNËN E DEÇANIT	40
4.1. Objektivat Strategjike dhe specifike	43
5. PANELI I EKSPERTËVE LOKAL/GRUPET TEMATIKE	48
5.1. Identifikimi i nevojave për zhvillimin ekonomik rural	50
5.2. Shporta me projekte dhe ide lokale	50
5.3. Strategjia zhvillimore lokale në përputhje me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 -2027	50
5.4. Strategjia Zhvillimore Lokale në pajtim me Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028	52
6. ZBATIMI I STRATEGJISË ZHVILLIMORE LOKALE 2024-2029	54
6.1. Monitorimi dhe Vlerësimi	54
6.2. Informimi i publikut	54
6.3. Legjitimiteti i Strategjisë	55
6.4. Projektet	55
6.5. Rishikimi i strategjisë zhvillimore lokale -Qasja Leader	55
6.6. Supozimet dhe Rreziqet	56
7. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET	56
SHTOJCA 1 . PLANI I VEPRIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE DHE NDARJA FINANCIARE 2024-2029, PËR SZHL 2024-2029	58

AKRONIMET

GLV -	Grupi Lokal i Veprimit
MBPZHR -	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
PZHR -	Plani për Zhvillim Rural
SBZHR -	Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
OS -	Objektivat strategjike
PZHK -	Plani Zhvillimor Komunal
BE -	Bashkimi European
LEADER -	Lidhjet midis aktiviteteve për zhvillimin e ekonomisë rurale
NVM -	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
IHD -	Investime të huaja direkte
PPP -	Partneritet Publiko Privat
MSA -	Mekanizmi i Stabilizim Asocimit
SZHL -	Strategjia e zhvillimit lokal
UA -	Udhëzim Administrativ
QPS -	Qendra për Punë Sociale
MPMS -	Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ -	Organizata Jo Qeveritare
SWOT -	Përparësit, Dobësit, Mundësit dhe Rreziqet



Unë, si Kryetar i Komunës së Deçanit, sa i përket strategjisë tonë të zhvillimit lokal, konstatoj se kemi përcaktuar dy degë të rëndësishme: zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin e turizmit.

Komuna e Deçanit ka marr pjesë aktive me ekspert të ndryshëm në takimet e organizuara për hartimin e kësaj Strategjie, duke dhënë ide dhe ekspertiza në finalizimin e planit dinamik që është program për investimet e ardhshme në Komunën e Deçanit, e sidomos në zonat rurale.

Këto nisma kanë si qëllim të ndihmojnë në rritjen e prodhimit të ushqimit dhe të promovojnë zhvillimin e zonave rurale e malore si një destinacion turistik tërheqës.

Në këtë drejtim, ne kemi bërë një angazhim për të mbështetur fermat dhe pemishtet bashkëkohore, duke siguruar teknologji dhe ekspertizë për të rritur prodhimin e tyre dhe kualitetin e produktit.

Në të njëjtën kohë, ne po përqëndrohemi në zhvillimin e turizmit, duke ndërtuar objekte turistike të reja dhe duke mbështetur sektorin e turizmit me investime dhe mbështetje.

Komuna e Deçanit, zotohet që do të vijojë të ofrojë mbështetje institucionale në vazhdimësi për të arritur objektivat e kësaj Strategjie.

Zhvillimi i qëndrueshëm i përcaktuar brenda kësaj Strategjie, nënkupton ruajtën e mjedisit dhe shfrytëzimin racional të resurseve natyrore për zhvillimin ekonomik dhe destinacione turistike.

Përkushtimi im, si Kryetar i Komunës, do të jetë i përqendruar në përmirësimin e jetës së qytetarëve Deçanas, duke e mbështetur fuqishëm zhvillimin dhe përmirësimin e standardit jetësor në zonat rurale dhe urbane.

Në fund të kësaj deklarate, do të dëshiroja të theksoj se Komuna e Deçanit, është e vendosur për të bërë hapa të mëdhenjë, për të rritur zhvillimin ekonomik dhe për të siguruar që banorët tanë të kenë një jetë më të mirë.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Bazuar në Udhëzuesin për Aplikim nga Programi për Zhvillim Rural 2023, Masa 5, për Përgatitjen, zbatimin e Strategjive Zhvillimore Lokale –Qasja Leader. GLV “Gjeravica”, është përfitues i kësaj skeme, ku do t`i zbatoj procedurat e kërkuara për Rishikimin dhe hartimin detal të SZHL-së.

Strategjia e zhvillimit të GLV Gjeravica 2024-2029, është dokumenti themelorë i planifikimit strategjik e cila përfshin të gjitha lokalitetet e kësaj komune si njësi administrative.

Dokumenti përcakton një kornizë të qartë strategjike në të cilën palët e interesit në grupin lokal të veprimit kanë mundësinë t`i shprehin kërkesat ose projektet e tyre në mënyrë të barabartë me qëllim të përmirësimit të cilësisë të jetës në zonën ku ata jetojnë.

Strategjia e Zhvillimit Lokal e GLV Gjeravica, është pjesë e përpjekjeve për të krijuar një model paraprak të qasjes së zhvillimit rural nga poshtë-lart duke u mbështetur në praktikat e Qasjes LEADER të BE-së.

Hartimi i një strategjie me pjesëmarrjen e grupeve të interesit për nevojat e zhvillimit lokal, krijon një qasje gjithëpërfshirëse ndaj një hapësire rurale që ka vazhdimësi territoriale, burimesh dhe mundësish për zhvillim të qëndrueshëm.

Përcaktimi i një sërë nevojash dhe prioritetesh për zhvillim nga GLV Gjeravica, është një mundësi më shumë që komunitetet rurale të marrin pjesë drejtpërdrejt si aktor me veprimet e tyre duke përmirësuar cilësinë e jetës dhe forcuar përgjegjësin e vendimmarrjes së përbashkët.

Promovimi i partneritetit publiko-privat, do të ofroj mundësi të reja për zhvillim të suksesshëm dhe menaxhim të duhur në zhvillimin e zonave rurale dhe do të kontribuoj drejtpërdrejtë në zhvillimin e produkteve të tij, marketingut dhe shitjeve, hulumtimit dhe teknologjisë, përmirësimit të infrastrukturës dhe zhvillimit të burimeve njerëzore.

Viset rurale ofrojnë mundësi të veçanta lidhur me potencialin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të punës, ofrimin e komoditetit dhe turizmin rural, dhe mbajnë rolin e një rezervuari të pasurive dhe peizazheve natyrore.

Në hartimin e SZHL 2024-2029, kanë marrë pjesë në cilësinë e eksperëve: Shkodran Gaxherri – ekspert kryesor dhe Egzon Binakaj – ekspert i dytë.

Bordi drejtues i GLV-së, ishte i përfshirë në mënyrë aktive në përgatitjen e mbajtjes së 12 takimeve me fokus grupe te ndryshme në teren dhe 5 punëtorive me grupe të ndryshme të interesit, formësimi i vizionit dhe misionit, synimeve me prioritete dhe masa, dhe finalizimin e këtij dokumenti.

PJESA 1

QËLLIMI I RISHIKIMIT TË SZHL DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

1. QËLLIMI I RISHIKIMIT TË STRATEGJISË

Programi për Zhvillim Rural 2023, përmes Masa 5, Zbatimi Strategjive të Zhvillimit Lokal – Qasja LEADER, si objektive kryesore ka përkrahjen e ngritjes së kapaciteteve të anëtarëve të GLV-ve, dhe banorëve rural, me qëllim të shtimit të shkathtësive të tyre në fushën e zhvillimit lokal.

Strategjia Zhvillimore Lokale 2024-2029, ka për qëllim të identifikoj potencialet ekonomike në zonën rurale dhe të propozoj një sërë rekomandimesh që do të kontribuojnë në promovimin e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm dhe të përmirësoj mirëqenien sociale në zonat rurale.

Mënyrat e jetesës në viset rurale dallojnë nga ato në viset urbane kryesisht për shkak të shërbimeve të kufizuara, sidomos shërbimet publike që janë në dispozicion. Shërbimet qeveritare si ato policore, shkollat, shërbimi i zjarrfikësve dhe bibliotekat në përgjithësi ekzistojnë, por mund të jenë të kufizuara apo edhe të mos ketë fare në bashkësitë (komunitetet) e largëta.

Shërbimet si uji, kanalizimi, ndriçimi i rrugëve dhe menaxhimi i hedhurinave publike, në përgjithësi, ka filluar të përmirësohet, por prapë se prapë në disa zona të largëta rurale akoma ka ngecje. Transporti publik është i kufizuar apo nuk ekziston fare. Njerëzit zakonisht përdorin automjetet e tyre personale.

Si rrjedhojë, komunitetet rurale po kërkojnë vazhdimisht mënyrat dhe mjetet për të marrë pjesë në mënyrë aktive në identifikimin e prioriteteve lokale si dhe shfrytëzimin e burimeve natyrore si mjet për zhvillimin e qëndrueshëm.

Qasja e zhvillimit lokal përmes ngritjes dhe fuqizimi të LAG-ve, përbën një risi për zonën ku shtrihet veprimtaria e GLV Gjeravica, por edhe një element të rëndësishëm për të nxitur partneritetin publiko – privat duke përfshirë grup moshat dhe gjininë femërore rurale në vendimmarrje dhe iniciativa konkrete.

1.1. Metodologjia për Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal -Qasja Leader

Qëllimi kryesor i GLV Gjeravica, është kontributi në zhvillimin ekonomik të zonave rurale, duke i ofruar përkrahje komunitetit rural për përgatitjen dhe zbatimin e strategjive zhvillimore.

Për të hartuar Strategjinë e Zhvillimit Lokal 2024-2029, të GLV Gjeravica, është shfrytëzuar materiali paraprak i Strategjisë së Zhvillimit Lokal dhe Plani Zhvillimor Komunal Deçan 2024-2032, si dhe të dhënat e mbledhura nëpërmjet bashkëpunimit institucional me Komunën Pejës.

Gjatë hartimit të SZHL, jemi fokusuar në disa pika përmbajtësore si:

- ⇒ Përkufizimin e Zonës/territorin e GLV-së, duhet të jetë koherente/kompakte dhe të ofroj masë/sasi të mjaftueshme të burimeve njerëzore, financiare dhe ekonomike për të mbështetur zbatimin e strategjisë së zhvillimit lokal;
- ⇒ Analiza e nevojave të zhvillimit dhe potencialit të zonës, duke përfshirë një analizë të pikave të forta, të dobëta, mundësive dhe rreziqeve (SWOT);
- ⇒ Përshkrimi i strategjisë dhe objektivave të saj, GLV-ja, përcakton vizionin dhe objektivat në përputhje me temat prioritare bazuar në PBZHR 2022-2027;
- ⇒ Përshkrimi i procesit të përfshirjes së komunitetit në përgatitjen e strategjisë, strukturën e partneritetit dhe rregullat e brendshme të vendimmarrjes;
- ⇒ Plani i veprimit/me objektiva dhe projekte të planifikuara për vitet 2024-2029;
- ⇒ Plani financiar me një buxhet tregues/orientues për periudhën e kohëzgjatjes së SZHL-së, i ndarë në: shpenzime operative ose të funksionimit të GLV-së, ndërtimin e kapaciteteve dhe për projekte të vogla.

Pas një përshkrimi të detajuar të elementeve më të rëndësishme të zonës rurale, plotësimin me të dhënat të marrura nga grupet tematike ishte një ndihmesë e mëtejshme për të realizuar analizën SWOT, nga e cila burojnë objektivat strategjike që do të duhet të ndiqen në secilën fushë me interes për zhvillimin ekonomik dhe social të zonës, dhe është përcaktuar në këto tema kryesore:

- Zhvillim të qëndrueshëm të bujqësisë, prodhimi dhe infrastruktura bujqësore;
- Zhvillimin e turizmit rural dhe malor;
- Zhvillimin e infrastruktura rurale dhe shërbimet në zonat rurale;
- Ruajtjen e mjedisit dhe menaxhimi sa më i mirë i resurseve tokësore dhe ujore;
- Menaxhimi i resurseve humane;
- Diversifikimi i të ardhurave të ekonomisë rurale;
- Çështjet gjinore dhe rinore.

Dokumentet që janë përdorur për realizimin e kësaj Strategjie.

- ↗ Ligji Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural;
- ↗ Programi për Zhvillim Rural 2023
- ↗ Plani Zhvillimor i Komunës së Deçanit 2024-2032;
- ↗ Shqyrtimi i dokumenteve strategjike komunale dhe materialet tjera në lidhje me zhvillimin rural;
- ↗ Strategjinë e dytë të zhvillimit rural 2014 – 2020, e cila është zhvilluar dhe mbështetur nga fondet e MBPZHR;
- ↗ Raporti i gjelbërt për bujqësi 2023;
- ↗ Programi Kombëtar për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2023-2027;
- ↗ Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028;
- ↗ Udhëzuesi për Aplikues Masa V.

Gjatë hartimit të SZHL, kontribut të çmuar dhanë anëtarët e GLV Gjeravica.

PJESA 2

GLV GJERAVICA

2. PROFIL I SHKURTËR RRETH GLV "GJARAVICA" KOMUNA DEÇAN

Grupi Lokal i Veprimit (GLV) "Gjeravica" është themeluar në vitin 2009, pas një periudhe dy vjeçare të ndërtimit të kapaciteteve dhe mbështetjes direkte nga projekti Strategjitë Zhvillimore Lokale (LDS), projekt i financuar nga BE-ja, dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian (ECLO) në Kosovë.

Prandaj, si çështje kyçe dhe synim kryesor i GLV "Gjeravica", mbetet gjetja e fondeve për realizimin e këtyre projekteve si mënyrë e vetme e implementimit të Strategjisë Zhvillimore Lokale.

Grupi Lokal "Gjeravica", është anëtar i rrjetit për zhvillim rural të Kosovës si dhe rrjetit të organizatave për zhvillim rural të Kosovës, i cili rrjet është anëtar i rrjetit për zhvillim rural të BE-së.

MISIONI

GLV-Gjeravica, ka synim t'i bashkojë organizatat ekzistuese publiko-private në komunën e Deçanit, për të promovuar zhvillimin e ekonomisë lokale, që synon menaxhim më të mirë të zonave rurale brenda territorit të komunës.


VIZIONI

Në pesë vitet e ardhshme, Deçani do të jetë vend me bujqësi të zhvilluar, turizëm dhe agro-turizëm të avansuar duke shfrytëzuar resurset natyrore dhe kulturore për zhvillim ekonomik, me mundësi të zhvillimit të infrastrukturës dhe sigurimit të shërbimeve për popullsinë rurale, me kujdes të veçantë për mbrojtjen e mjedisit.

2.1. Bordi menaxhues

Struktura e bordit dhe Kuvendit të përgjithshëm duhet të iu përmbahet kriterëve bazuar në Udhëzim Administrativ (UA) të MBPZHR, për masat dhe kriteret e përkrahjes për zhvillim rural për vitin 2023, sipas Masa 5 "Përgatitja dhe Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal – Qasja LEADER, qartësohet në Nenin 24 të UA: pikat 10.4 dhe 10.5 për nivelin e vendimmarrjes.

Struktura Organizative e GLV Gjeravica.



Në nivel administrate, autoriteti menaxhues i MBPZHR bashkërisht me GLV-të, dhe akterët tjerë të angazhuar për të kontribuar në zhvillimin e zonave rurale nevojitet të përgatisin politika të favorshme për funksionalizimin dhe implementimin e qasjes LEADER.

Gjithashtu, GLV-të, nuk janë ende të fuqizuara, as teknikisht të gatshme për të nisur thirrje të hapura për përzgjedhjen e projekteve që duhet të përshtaten me prioritetet vendore.

Pavarësisht përvojës së mirë në qasjen LEADER, GLV-të, ende kanë nevojë për mbështetje për hulumtimin e fondeve dhe përgatitjen e aplikacioneve-projekt propozimeve, përgatitjen e Strategjive Zhvillimore Lokale dhe zbatimin e tyre.

Për ndarjen e funksionit të menaxhimit nga funksioni i përzgjedhjes së projekteve, GLV-të, duhet të trajnohen – shkëmbejnë përvoja nga GLV-të, me përvojë nga shtetet anëtare të BE-së.

GLV Gjeravica, gjatë një periudhe 10 vjeçare, ka realizuar mbi 17 projekte të ndryshme, në kuadër të Masave Mbështetëse Institucionale për GLV-të, nga MBPZH, por edhe me bashkëpunime ndërkufitare Grante të BE-së.

2.2. Strategjia e Zhvillimit Lokal -Qasja Leader 2024-2029

Proceset e hartimit të strategjive të zhvillimit me pjesëmarrje të komunitetit, ndeshen me vështirësi të shumta, për të arritur suksesin e tyre. Nga ana tjetër vetë procesi i planifikimit përdorë një strategji të caktuar dhe qëllimi është të arrihet një rezultat i prekshëm për komunitetet e zonës së caktuar.

Ky planifikim strategjik, është i ndryshëm dhe varet nga madhësia e territorit dhe tërësia e problemeve dhe përfshin hapa të tillë si mbledhja e të dhënave, identifikimi i grupit të planifikimit e deri tek draft plani strategjik apo mënyra sesi ai do të zbatohet.

Qasja e zhvillimit lokal përmes ngritjes dhe fuqizimi të GLV-ve, përbën një risi për zonën ku do të shtrihet veprimtaria e GLV Gjeravica, por edhe një element të rëndësishëm për të nxitur partneritetin publiko – privat.

Programi LEADER, gjithmonë i ka konsideruar komunitetet lokale si pasuri kryesore të zonave rurale dhe karakteristika dalluese të projekteve nga GLV-të, dhe ka qenë vëmendja ndaj banorëve që jetojnë në këto zona dhe aftësisë së tyre për të vlerësuar përmes një procesi gjithëpërfshirës se çfarë është më e përshtatshme për mjedisin, kulturën, traditat dhe aftësinë e tyre.

Është shumë me rëndësi që komunat dhe MBPZHR, të pranojnë siç duhet dhe të mbështesin dhe forcojnë GLV-të, gjatë fazave të tyre.

2.3. Takimi Informues

Takimi informues është mbajtur me datë: 11.09.2024, në Restaurant Iliria në Deçan, me përfaqesuse Institucionale dhe grupe të ndryshme të interesit, ku prezent ishte edhe Kryetari i Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj, i cili me fjalimin e tij e përgëzoj GLV Gjeravicën për punën e bërë dhe angazhimin e ri në hartimin e Strategjisë 2024-2029.



Foto 1. Takimi Informues me Institucionet Komunale dhe grupe tjera në fokus

Në takim u shpalos Programi për Zhvillim Rural 2023 dhe Masa V- Përgatitja /Zbatimi i Strategjive të Zhvillimit Lokal 2024-2029 – qasja LEADER, që ka të bëjë me Hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Lokal.

Në takim ishin prezent 29 pjesëmarrës.

Në pajtim me Projekt Propozimin dhe Kontratën e nënshkruar, GLV-Gjeravica, ka zhvilluar aktivitetet në vijim:

2.4. Identifikimi i grupeve

Ky ka qenë hapi i parë nga GLV-ja, për identifikimin dhe kontaktimin e akterëve të mundshëm lokal. GLV Gjeravica, gjatë muajit Gusht – Shtator 2024, në koordinim me Ekspertët për Hartimin e Strategjisë Zhvillimore Lokale, kemi hartuar planin dinamik të zhvillimit të aktiviteteve dhe formulimin e axhendave për fillimin e organizimit të takimeve me grupet në fokus si: Përfaqësuesit e bashkësive lokale /kryetarët e këshillit të fshatit/, Bujqësi dhe blegtori, perimekulturë, agro-përpunuesit e pemëve të imta, bletarët, përpunues të mishit, përfaqësues të agro-turizmit, përpunues të qumështit, shoqatat e grave, shoqatat e të rinjëve, grupet e të rinjëve, zhvilluesit e artizanateve etj, organizatat që veprojnë në sektorin publik dhe privat dhe nga propozimet e tyre dhe rekomandimet kemi ardhur në përfundim që të hartojmë këtë strategji, sipas qasjes LEADER.

2.5. Organizimi i 12 vizitave në teren

Në koordinim të ngushtë me Menaxhmentin e GLV-Gjeravica dhe Ekspertin 2, janë organizuar takimet në teren me çrast është biseduar për partneritetin publiko-privat dhe rolin e qasjes Leader, gjithashtu ballafaqimi me sfidat dhe dhënia e ideve.

Pjesëmarrësit e grupeve punuese ishin nga: Kryetarët e këshillit të fshatrave në zonat rurale, përfaqësuesit e organizatave lokale si OJQ-të, fermerët privat, blegtorë, pemëtar, bletar, gratë në biznes dhe grupe të të rinjëve. Janë bërë të gjitha përpjekjet për të zhvilluar procesin përmes një konsultimi të lirë, ku janë mirëpritur dhe marrë parasysh të gjitha kontributet.

Nga pjesëmarrësit është kërkuar që të propozojnë projekt idetë për të përmirësuar kushtet e jetesës në këto zona. Gjatë takimeve, qytetarët kanë shprehur një interesim të madh në aspektin e zhvillimit të bujqësisë, infrastrukturën e ujitjes, rritjen e shkallës së subvencioneve, ndalimin e produkteve perimore nga jashtë në pikë sezonin e prodhimeve vendore dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Të gjitha idetë, sugjerimet do prezantohen në SWOT analizë dhe në shportën e projekteve të kësaj SZHL -2024-2029.

Vizitat u organizuan si në vijim: Gjatë këtyre takimeve morën pjesë 166 pjesëmarrës.

Nr	Vendi i vizitës	Data	Pjesëmarrës
1	Carrabreg i Ulët	13.09.2024	12
2	Llukë	14.09.2024	14
3	Rastavicë	16.09.2024	8
4	Shoqata e Gjahtarëve	17.09.2024	14
5	Klubi i futbollit të femrave	19.09.2024	13
6	Baballoq	20.09.2024	13
7	Dashinoc	23.09.2024	14
8	Shoqata e Bletarëve	24.09.2024	12
9	Prapaqan	25.09.2024	12
10	Blegtorët e Komunës së Deçanit	26.09.2024	20
11	Biznese prodhuese në Deçan	27.09.2024	20
12	Prejlep dhe ekspertë Komunal	30.09.2024	14



Foto 2 dhe 3. Takimi i organizuar në fshatin Carrabreg dhe Dashinoc

2.6. Organizimi i 5 punëtorive me palët me interes

Hapi i radhës për zhvillimin e strategjisë, ka qenë organizmi i pesë punëtorive me akterë të ndryshëm. Punëtorit kanë filluar nga data: 21.10.2024, në këto punëtori morën pjesë përfaqësues të Institucioneve nga Komuna e Deçanit, Kryetarët e bashkësive lokale dhe këshillit të fshatrave në zonat rurale, zhvilluesit e turizmit, bujqësisë dhe blegtorisë, perimekulturës, shoqatat e fermerëve, shoqatat e grave, grupet e të rinjve, përfaqësues të monumentet të trashëgimisë natyrore dhe kulturore, etj.

Në të gjitha punëtorit pjesëmarrësit u njoftuan me rëndësinë e projektit dhe rolin e grupeve të interesit për të kontribuar në hartimin e Strategjisë.

Pjesëmarrësit kishin një rol shumë të rëndësishëm duke kontribuar direkt në hartimin e SWOT analizës si dhe propozimin e projekteve.

Në vazhdim, pjesëmarrësit u njoftuan për rëndësinë e tyre në vendimmarrje sipas qasjes LEADER, dhe krijimin e shportës së projekteve sipas prioriteteve dhe hartimin e listës me grupet e ekspertëve sipas fushave përkatëse.

Pastaj është bërë analizimi i shportës së projekteve dhe janë përcaktuar edhe prioritetet për Strategjinë Zhvillimore Lokale 2024-2029.

Me ndihmën e ekspertit, në rolin e lehtësuesit janë diskutuar dhe analizuar sfidat në zonat rurale dhe mundësit për përmirësimin e jetës.

Janë diskutuar çështje kyçe rreth mundësisë së menaxhimit më të mirë të mbeturinave dhe krijimit të hapësirave të gjelbërta, furnizimi me ujë të pijes dhe ujitjen e tokave bujqësore me ndërtimin apo rehabilitimin e kanaleve ekzistuese, ndërtimi i këndeve për lojëra të fëmijëve, ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore, etj.

Punëtorit u organizuan me fokus grupe të ndryshme si në vijim:

Temat në 5 Punëtorë	Data e punëtorëve	Pjesëmarrës në takime	Numri pjesëmarrësve
- MASA – V, Roli i çasjes LEADER -GLV-ja, - Prezantimi i projekt ideve nga 12 vizitat në teren dhe identifikimi i projekteve të reja nga pjesëmarrësit - Përgatitja e SWOT analizës - Ndarja në prioritetet e projekteve, përgatitja e Listës së Panelit të Eksperteve - Finalizimi i Shportës së projekteve	21.10.2024	Institucionet lokale, shoqata dhe GLV	24
	22.10.2024	Shoqatat e fermerëve dhe zyrtar komunal	20
	23.10.2024	Përfaqësues nga bizneset dhe zyrtar komunal	19
	24.10.2024	Shoqatat e grave, gra ne biznes dhe zyrtare komunale	23
	25.10.2024	Të rinjtë dhe ekspert të urbanizmit	24

Gjatë këtyre punëtorëve morën pjesë 110 pjesëmarrës.



Foto 4-7. Organizimi i 5 punëtorëve me grupet e ndryshme të interes



Foto 8. Takimi i fundit ne përzgjedhjen e panelit te ekspertëve dhe vlerave financiare për projekte

2.7. Organizimi i dy vizitave në GLV-të në Regjione të ndryshme

Këto vizita kanë pasur për qëllim shkëmbimin e përvojave me GLV -të, në Kosovë. Gjatë këtyre takimeve nga Bordi i Drejtorëve, janë realizuar dy vizita në dy GLV në Regjion, ku janë shkëmbyer përvoja të ndryshme me përfaqësues të këtyre GLV-ve, rreth hartimit të Strategjisë dhe përvoja tjera rreth realizimit të projekteve të ndryshme.

Vizitat u organizuan në GLV-të, e Komunave: Skenderaj / GLV Perspektiva/ me datë: 09.10.2024, dhe Pejë /GLV Agroturizmi/ me datë:17.10.2024.



Foto 9-10. Organizimi i vizitave të GLV –të, tjera në Kosovë

2.8. Organizimi i Seminarit përfundimtar në nivel lokal

Në këtë Seminar të organizuar nga GLV Gjeravica, me datë: 13.11.2024, është bërë një prezantim nga Kryetari i GLV Gjeravica për praktikën e mira të zhvillimit të bujqësisë, dhe agro-turizmit dhe në vazhdim nga eksperienti i hartimit, është bërë prezantimi i Draft Strategjisë Zhvillimore Lokale 2024-2029 – Qaja Leader, ku nga pjesëmarrësit u dhanë sugjerimet e tyre dhe të gjitha konkluzionet janë inkorporuar në Strategjinë finale.

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së SZHL, u prezantuan edhe Objektivat Strategjike me projektet e identifikuara nga grupet pjesëmarrëse gjatë realizimit të të gjitha aktiviteteve.

Gjithsejtë 83 projekt ide të grumbulluara, për periudhën 5 vjeçare me një kosto financiare prej: 3,622,000.00€



PJESA 3

STRATEGJIA LOKALE PËR ZHVILLIM RURAL NË KOMUNËN E DEÇANIT

3. DEFINIMI I ZONËS -PROFIL I SHKURTËR I KOMUNËS SË DEÇANIT

Profili Komunal paraqet përmbledhjen e informatave të përgjithshme mbi gjendjen aktuale gjeografike, fizike, sociale dhe ekonomike. Ajo e prezanton pozitën e Komunës së Deçanit, rëndësinë në çështjet specifike të komunës brenda kontekstit të Kosovës, bënë krahasim të gjendjes lokale me sektorët e ndryshëm të nivelit qendror dhe me normat teknike, ofron informata të rëndësishme në lidhje me udhëzimet dhe detyrimet që rrjedhin nga dokumentet e miratuara në nivel lokal dhe qendror.¹

3.1. Zhvillimi demografik /Popullsia dhe zona/

Bazuar në regjistrimet e vitit 2024, Komuna e Deçanit llogaritet të ketë një shifër prej: **27.758** banorëve, çka dmth, se ka rënie të numrit të popullsisë në këtë komunë, krahasuar me regjistrimin e vitit 2011, ku janë llogaritur mbi **45.000** banorë.

Në qytetin e Deçanit, mesatarisht familjet i kanë nga 6.3 anëtarë, ndërsa mesatarja e anëtarëve të familjes në Komunën e Deçanit, është 6.8 anëtar sipas Regjistrimit të Popullsisë në vitin 2011.

Deçani është qendër administrative, politike, ekonomike, arsimore, shëndetësore dhe kulturore ndërsa territori i komunës i përfshinë (përpos qytetit të Deçanit) edhe 37 vendbanime tjera - fshatra: Baballoq, Beleg, Belle, Carrabreg i Ulët, Carrabreg i Epërm, Dashinoc, Drenoc, Dubovik, Dubravë, Shaptej, Glllogjan, Gramaqel, Hulaj, Irzniq, Isniq, , Kodrali, Lëbushë, Lloqan, Llukë e Epërme, Llukë e Ulët, Lumbardh, Maznik, Vranoc i Vogël, Papiq, Pleqe, Pobergjë, Pozhar, Prapaqan, Prilep, Prokolluk, Rastavicë, Ratishë i Epërm, Ratishë i Ulët, Sllup, Strellc i Epërm, Strellc i Ulët dhe Voksh.

Shpesh mendohet se migrimi është një fenomen i kohëve të fundit por megjithatë migrimi ka qenë një tipar që nga koha e ekzistencës njerëzore për shekuj me radhë. Migrimi gjithmonë ka qenë individual apo në grupe dhe synimet kanë qenë pothuajse të njëjta siç janë: për të fituar lirinë nga lufta dhe konfliktet e ndryshme, për t'i shpëtuar urisë dhe varfërisë, jo tolerancës fetare, shtypjes politike, për rritjen e cilësisë së jetës nëpërmes gjetjes së mundësive të reja ekonomike dhe punësimi, për tregti dhe udhëtime në vende tjera të botës.


3.2. Pozita Gjeografike:

Komuna e Deçanit, ndodhet në perëndim nga kryeqyteti i Prishtinës në distancë 88 km vijë ajrore, në Rrafshin e Dukagjinit rrëzë Bjeshkëve të Nemuna në koordinatat 42°32'00"N dhe 20°17'00"E. Ka pozitë të mirë gjeografike në rrugën magjistrale Pejë – Gjakovë – Prizren që e lidhë pjesën veriore dhe jugore të Dukagjinit. Vija ajrore me Detin Adriatik është 90 km, ndërsa përmes Pejës lidhet me hekurudhën që e lidhë Dukagjinin me Fushë Kosovën. Në pjesën perëndimore kufizohet me Republikën e Shqipërinë nëpërmes qafës së Morinës dhe ofron mundësitë mira të lidhjes me vendbanimet në pjesën verilindore të Shqipërisë. Në veri

¹ Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032

perëndim kufizohet me Malin e Zi ndërsa në verilindje kufizohet me Komunën e Pejës. Në lindje pjesërisht kufizohet me Komunën e Gjakovës ndërsa në jug dhe jug perëndim kufizohet me Komunën e Junikut.

Nga Peja është larg 15 km, nga Gjakova 21 km, nga Prizreni 58 km, dhe nga Prishtina 94 km. Figura 7 Pozita e komunës Deçanit në Kosovë Komuna e Deçanit, shtrihet në një sipërfaqe



prej 293,94 km² e ndarë në qytetin e Deçanit, lagjet urbane dhe fshatrat.

Sipërfaqja e Komunës Deçanit e përbën 2.69 % të sipërfaqes së përgjithshme të Republikës së Kosovës dhe renditet si Komuna e 20-ta për nga madhësia e territorit Komunal.

Lartësia mbidetare lëvizë nga më e ulëta në fshatin Maznik 412 m dhe me e larta që përfshinë masivin e Bjeshkëve të Nemuna, Majën e Gjeravicës me 2656 m lartësi mbidetare. Në sajë të krijimit të reliefit Komuna e Deçanit, ndahet në dy pjesë:

- Në ultësi që është pjesë e rrafshit të Dukagjinit
- Në lartësi që përfshin masivin e Bjeshkëve të Nemuna (Alpet Shqiptare).

Foto 11. Pozita gjeografike e Komunës së Deçanit në Kosovë /burimi PZHK 2024-2032 Komuna Deçan/

3.3. Karakteristikat e hidrografisë²

Lumëbardhi i Deçanit - Më gjatësi 40,5 km që buron në Bjeshkën e Roshkodolit në vendin e quajtur, Tëdel i Lumëbardhit në lartësi mbi detare 2130 m. Pellgu i tij përshkon fshatrat: Deçan, Isniq, Llukë e Epërme dhe Llukë e Ulët, Lumbardh, Prapaqan, Papiq dhe Broliq, fushat e të cilave fshatra i ujit, si dhe furnizon me ujë liqenin akumulues të Radoniqit. Shtrati Lumëbardhit duhet të rregullohet në tërësi nga Manastiri i Deçanit e deri në fshatin Lumbardh me gjerësi prej 50 m në të dy anët e lumit ku rregullimi në të dy anët e tij do të merrte funksionin e shëtitorës. **Lumëbardhi i Lloqanit** - Më gjatësi 23,7 km që buron nga shpatijet e Kurvallës, Dervish-Komit dhe të Stanishtës së Zogut në lartësi mbi detare 2100 m. Pellgu i Lloqanit përshkon fshatrat Hulaj, Lloqan, Carrabreg i Epërm, Prilep, Rastavicë, Baballoq dhe Gramaqel. Ky lumë përveç që ujit fushat e këtyre fshatrave, uji i tij përdoret për ujitje të fushave edhe të shumë fshatrave të tjera si: Pobergjë, Voksh, Sllup, Drenoc etj. ku shtrati dhe brigjet e lumit janë pjesërisht të rregulluara. Në lumenjtë që përshkojnë territorin komunës sonë, në ta ekzistojnë kushte shumë të volitshme për kultivimin dhe rritjen e peshkut dhe ndërtimin restoranteve dhe hoteleve që do të kishte efekt shumë pozitiv socio-ekonomik dhe turistik. Potenciali ujor i “Bjeshkëve të Nemuna”, në masë të madhe

² Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032

është i grumbulluar nëpër rezervuare, prej nga distribuohet si ujë i pijshëm nëpër ujësjellës të vendbanimeve dhe shfrytëzohet nga qytetarët për pije kurse pjesën tjetër popullata e shfrytëzon për ujitje të sipërfaqeve bujqësore.

Burimet minerale - Burimet minerale dhe termale ndeshen në katër lokalitete të Rrafshit të Dukagjinit, ku një nga këto burime më i njohuri është ai i Ujit të thartë afër Manastirit të Deçanit. Për shkaqe të shpalljes së asaj pjese si zonë të rëndësisë së posaçme, në të cilin gjendet burimi, ajo pjesë ka mbetur pa një infrastrukturë të rregulluar turistike, si dhe nuk ka qenë i mundur shfrytëzimi komercial i këtij burimi. Gjendja e tanishme e burimit nuk ofron kushte për eksploatimin tij, si dhe për vizitorët. Në të ardhmen, mendohet rregullimi i infrastrukturës për këtë burim, si dhe mundësia e hapjes së ndonjë reparti për mbushjen e shisheve më ujë në afërsi të burimit, duke i ditur edhe cilësitë e tij të ndryshme shëndetësore.

Lartësia mbidetare - Bjeshkët e Nemuna apo Alpet Shqiptare, shtrihen në pjesën perëndimore të Komunës së Deçanit, që i takon nga sipërfaqja e përgjithshme e Parkut Kombëtarë, me përfshirje-sipërfaqe prej 16,786 ha apo 27 % nga territori i Bjeshkëve të Nemuna i takon Komunës së Deçanit. Lartësitë e Bjeshkëve të Nemuna, pak ndryshojnë nga lartësia e vargmaleve alpine të tjera. Këto janë pjesët më të larta dhe më shkëmbore të vargmaleve të Siujdhesës Ballkanike, me ç' rast shkëmbinjtë formojnë pamje imponante. Nga masivi i Bjeshkëve të Nemuna, mund të veçojmë këto maja më të larta me lartësi mbi detare siç janë Maja e Gjeravicës 2656 m, Maja e Marjashit 2533m, Maja e Rupes 2501 m, Maja e Qenit 2406 m, Maja e Strellcit 2377 m.

Klima - Komuna e Deçanit, ka klimë kontinentale me ndikim të klimës mediterane ku gjatë vitit në Deçan, ka 1945 orë me diell. Viset e ulëta të Deçanit, karakterizohen me temperatura relativisht të larta me vlerë mesatare vjetore më tepër se 11°C, me muajt më të nxehtë gushtin dhe korrikun 21.7°C dhe 22.7°C dhe me muajin më të ftohtë janarin – 0.5°C. Në klimë ndikon shumë afërsia “Bjeshkëve të Nemuna” dhe rrymat e tjera të ajrit, që në viset e ulëta karakterizohet më vera të nxehta dhe të thata dhe më dimra relativisht të ftohtë dhe më lagështi.

3.4. Zhvillimi Ekonomik

Komuna e Deçanit, ka një potencial mjaft të mirë të zhvillimit ekonomik, bazuar në resurset ekzistuese. Pozita e saj gjeografike ndodhur në mes të trekëndëshit Kosovë, Mal i Zi dhe Shqipëri (nëpërmes Komunës Junikut) por edhe në mes të Komunës Pejës, Gjakovës, Juniku ofrojnë potenciale ekonomike. Sipërfaqet e konsiderueshme me tokë bujqësore, pyje, ara, livadhe e kullosa, ofrojnë një bazë të mirë për zhvillimin ekonomik ndërsa në anën tjetër zona malore është potencial i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm. Po ashtu në këtë komunë zhvillohen mjaft ndërmarrjeve individuale, tregti, industrinë e lehtë, gjithashtu resurset e trashëgimisë natyrore dhe kulturore ofrojnë mundësi të mirë për zhvillimin ekonomik lokal. Komuna e Deçanit, në të ardhmen ka për qëllim të ofroj shërbime bashkëkohore dhe efikase dhe të mbështetet në potencialet ekzistuese natyrore në avancimin dhe ngritjen e kapaciteteve profesionale njerëzore. Qëllimi kryesor është që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm ekonomik duke i shfrytëzuar resurset natyrore dhe kulturore në

mënyrë racionale, por gjithsesi duke i lënë mundësinë edhe gjeneratave të ardhshme që t'i shfrytëzojnë këto resurse. Në Komunën e Deçanit, aktivitetin e tyre e ushtrojnë 2254 ndërmarrje, dhe në bazë të kriterëve mbi vlerësimin e madhësisë së ndërmarrjeve dhe numri i të punësuarve, pjesa dërmuese e tyre i takon ndërmarrjeve individuale me aktivitet prodhues, tregtar, ndërtimor dhe shërbyese.

Punësimi - Shkalla e Papunësisë, vazhdon të jetë një nga sfidat kryesore të ekonomisë së Kosovës, e cila reflektohet me probleme të shumta në shoqëri. Shkalla e papunësisë në nivel të Kosovës sipas Anketës së Fuqisë Punëtore 2022, është 12.6% (58 081 persona të moshës 15-64 vjeç) dhe llogaritet të jetë më e larta në rajon. Mirëpo, krahasuar me vitin 2021 ka një rrënjë prej 8.1% ku në këtë mes, niveli i papunësisë është më i lartë për femrat me 16.5% se sa për meshkujt me 11%. Komuna e Deçanit nuk është e vetmja komunë e cila përballet me sfida të papunësisë.

Shkalla e Punësimit në Anketën e Fuqisë Punëtore (AFP), për vitin 2022, është 33.80 %³⁰, apo 403813 persona. Punësimi me i lartë është te meshkujt 49.4% në moshë pune, ndërsa punësimi të femrat është 18.4% në moshë pune. Femrat janë të punësuar, kryesisht në këta sektorë: arsim, kujdes shëndetësor dhe tregti, me 51.2 % të tyre, ndërsa meshkujt janë kryesisht të punësuar në sektorët: ndërtimtarisë, tregtisë dhe prodhimit, me 42.3%.³

3.5.Turizmi

Duke vlerësuar potencialet natyrore dhe trashëgimisë kulturore e arkitekturore me të cilat disponon Komuna e Deçanit⁴, mundësia e zhvillimit të turizmit si një sektor i rëndësishëm ekonomik, paraqet një nga shtyllat kryesore të zhvillimit të komunës. I kufizuar me vargmalet në pjesën veriore, perëndimorë dhe jugor, kufizimi me dy shtete, lumenj dhe burime minerale, Komuna e Deçanit posedon potenciale të mëdha në zhvillimit të turizmit malor, rekreativ, sportiv, eksplorues, shëndetësor, agro turizmit (rural) dhe turizmi kulturor. Deri me tani në Komunën e Deçanit janë të identifikuar tre lloje të turizmit:

- Turizmin transit, pra si pikë kalimi për në vendet tjera në Kosovë apo nga Kosova në shtetet fqinje,
- Turizëm vikendi duke ofruar oferta për qëndrim gjatë vikendit.
- Turizëm qëndrimi i cili përfshinë pika qëndrimi turistik shumë ditorë si në zonat urbane dhe rurale.

Në të kaluarën Komuna e Deçanit ka qenë e njohur edhe për pushimorën dedikuar fëmijëve në vendin e njohur si “Pishat e Deçanit”. Turizmi në Komunën e Deçanit nuk është i zhvilluar në nivelin e duhur përkundër potencialeve që i posedon të kombinuara në mes të trashëgimisë natyrore, kulturore, arkitekturore dhe arkeologjike. Turizmi malorë në Komunën e Deçanit është më i parapëlqyeri ndërsa i përcjellë me atë rural (me shumë kulla dhe tradita) dhe më pak ai urban.

³ Anketa e Fuqisë Punëtore 2022, ASK

⁴ Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032

Me 13. Dhjetor 2012 vargmalet e Bjeshkëve të Nëmura shpallen “Park Kombëtar” dhe miratohet Ligji Nr. 04/L – 086 “Ligji për parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna”. Duke iu referuar neneve të këtij ligji gjegjësisht Neni 3. Regjimet e Mbrojtjes, të gjitha propozimet për zhvillimin e kësaj zone duhet të janë në përputhje me regjimet mbrojtëse të zonës parë, dytë, tretë dhe katërt. Andaj gjatë hartimit të projekt PZHK-së, të gjitha veprimet për zhvillimin e zonës turistike në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” janë marr në harmoni të plotë me Ligji Nr. 04/L – 086 për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”.



Foto 12. Bukurit turistike të Deçanit / foto e huazuar nga visit Deçani/

Për lehtësim të orientimit drejt zonave turistike dhe pikave të interesit, deri më tani është realizuar edhe sinjalizimi i shtigjeve për alpinizëm dhe biçikleta. Është hapur edhe Qendra për Informim Turistik në Deçan, e cila ofron material promovues dhe informues për Bjeshkët e Deçanit, siç janë: Fshati i Pleqes, Fshati historik Belle, Bjeshka e Strellcit, Bjeshka e Kurvallës - Lloqanit, Bjeshka e Prilepit, Bjeshka e Milishevcit, Bjeshka e Roshkodolit, Bjeshka e Madhe - Deçanit, Bjeshka e Budoshit, Bjeshka e Lumëbardhit, Bjeshka e Irzniqit, Bjeshka e Zllonopojës, Bjeshka e Baballoqit, Bjeshka e Pllaqicës, Bjeshka e Carrabregut - Korë, Bjeshka e Jedovës dhe Bjeshkët e Belegut. Në të gjitha bjeshkët e lartpërmendura interesimi nga vizitorët është gjithnjë e në rritje ndërsa në dimër ato po zgjojnë interes për sportet dimërore. Deri me tani në Komunën e Deçanit janë të identifikuara tre zona turistike nga të cilat dy janë private dhe një publiko - shoqërore.

Kapacitet akomoduese janë më të larta në zonën rurale në krahasim me atë urbane ndërsa të dhënat nga Qendra Informuese Turistike në Komunën e Deçanit tregojnë se nga viti 2011 deri në vitin 2022 në të dy zonat ka rritje kapaciteteve akomoduese. Në zonën urbane nga viti 2011 kur ishin 643 akomodime, në vitin 2022 kemi rritje në 1147 akomodime kurse në zonën rurale nga 1673 akomodime në vitin 2011, kemi rritje në 5356 akomodime në vitin 2022.

Deri më tani llojet e turizmit të cilat ofrohen nga Komuna e Deçanit janë:

Turizmi malor - Deçani ka vende atraktive turistike, që shfrytëzohen nga vizitorët për ekskursionë, për sport, rekreacion, pushim, kulturë, për arsim e edukim. Me turizmin malor nënkuptojmë lëvizjen e njerëzve me qëllim rekreacioni, argëtimi, shërimi dhe zgjerimi të njohurive kulturore. Të gjitha Bjeshkët e Deçanit, kanë terene shumë të mira për zhvillimin e turizmit malor, të cilat ofrojnë mundësi reale për ecje dhe biçikleta e që këtu duhet të ceken zhvillimi i aktiviteteve “Via Dinarica” dhe “Peaks of Balkan” (Majat e Maleve Ballkanike). Zhvillimi i ardhshëm i turizmit malor do të jetë në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për “Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna ” dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë. **Turizmi rekreativ dhe sportiv** - Bjeshkët e Deçanit, posedojnë burime natyrore rekreative me terene sportive për zhvillimin e turizmit rekreativ dhe sportiv. Turizmi rekreativ është lëvizja e njerëzve në kohën e tyre të lirë për të kaluar kohën në terene atraktive ku burimet rekreative janë të pranishme në të gjitha Bjeshkët e Deçanit.

Bjeshka Belegut - paraqet një produkt turistik të rëndësishme jo vetëm për zhvillim lokal, por dhe për Kosovën në përgjithësi ku duhet në të ardhmen të investohet në infrastrukturën turistike në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për “Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna ” dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.



Foto 13. Bukurit e bjeshkëve të Deçanit / foto e huazuar nga Deçani ynë – Jetmir Tahiraj/

Turizmi veror dhe dimëror - Ky lloj i turizmit është mjaft i përhapur në Bjeshkët e Deçanit, duke u bazuar në burimet e shumta ujore, peizazhet piktoreske, terenët e përshtatshme për infrastrukturë turistike. Lokacionet që ofrojnë kushte për turizmin veror dhe dimëror dhe që kanë vlera turistike janë të gjitha në Bjeshkët e Deçanit. Si produkt turistik është edhe shtegu i hekurt “Via Ferrata”, i cili është një atraksion i veçantë turistik për ecje dhe ngjitje, që ndodhet përgjatë Grykës së Deçanit të Kërshi i Qelisë, 4 km larg qendrës së qytetit pastaj Shtëpia Bjeshkatore Alpine “Shkëlzen Haradinaj” të Bjeshka e Belegut më largësi 18 km nga qyteti, fshati turistik në Belle dhe fshatin Pleqe. Turizmi veror dhe dimëror në të ardhmen në Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do të zhvillohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për “Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna ” dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.

Speleoturizmi (shpellave) - Për opinionin e gjerë nuk janë të njohura bukuritë natyrore të Shpellës së Bojkut dhe Shpella në fshatin Belle, në të cilën shihen gjurmët e njerëzimit, që kanë qenë aty brenda po ashtu nën shpellë ka edhe liqe dhe burime të tjera ende të pa hulumtuara dhe studiura, të cilat janë pasuri për vendin. Të gjitha zhvillimet e Speleoturizmit në pjesën e parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do të zhvillohet në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për “Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna” dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.

Turizmi rural dhe kulturor - Në shumë zona rurale të Komunës së Deçanit, ka monumente kulturore me potencial arkitektonik – kullat, po ashtu duke përfshirë edhe kulturën materiale - shpirtërore ku ende ruhen shumë zakone, tradita, lojëra tradicionale, këngë, veshje e ushqime tradicionale, që ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e turizmit rural. Këto pasuri të jashtëzakonshme kulturore janë mundësi e mirë për zhvillimin e turizmit rural dhe promovimit të këtyre vlerave. Për këto vlera shquhen këto fshatra, të cilat janë: Pleqe, Belle, Hulaj, Voksh, Drenoc, Glllogjan, Isniq, Dubovik, Strelc i Epërm. Turizmi rural i cili zhvillohet brenda Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” do zhvillohen në të ardhmen në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 04/L – 086 për “Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna” dhe me Planin Hapësinorë të Parkut Kombëtarë.

Turizmi kurativ (shëndetësor) – në vitet e fundit është zhvilluar mjaft në të gjithë Komunën e Deçanit e me theks të veçantë në zonën malore. Prezenca e llojllojshmërisë së florës ka ndikuar në rritjen e interesimit për t’i vizituar këto zona dhe grumbulluar bimë të ndryshme për shërim.

Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” - paraqet një regjion gjeografik me bukuri të rrallë, me pasuri të madhe të elementeve të peizazhit si: bjeshkë të larta të veshura me dëborë në maja, pyje mbresëlënëse me lloje të ndryshme ku me bukuri dominojnë pishat e larta, lugina magjepsëse e gryka të thella mahnitëse, kullosa e livadhe me lule të gjitha ngjyrave, burime e rrjedha të shumta ujore që formojnë përroska e lumenj, shpella të bukura dhe liqene përrallore në bjeshkët e larta. Bjeshkët e Nemuna e përbejnë 26% të sipërfaqes së Komunës Deçanit.

Turizmit ndërkufitar shtigjet - (Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike) - është një fushë e cila ka ndikuar në promovimin e Komunës së Deçanit dhe në rritjen e zhvillimit ekonomik për vendbanimet buzë kufijve në mes të Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Ku lloj i turizmit përpos zhvillimit ekonomik të vendbanimeve buzë kufijve, ai po ashtu ka arritur që t’i ruaj traditat, zakonet dhe lidhjet e kamotshme të këtyre viseve. Ecja malore ose ndryshe hiking dhe çiklizmi malor janë disiplinat të cilat janë zhvilluar më së shumti në dekadën e fundit në këtë rajon. Në këtë drejtim janë zhvilluar projekte madhore siç janë shtegu Via Dinarika dhe Majat e Maleve Ballkanike.

Qendra Turistike Informuese - e cila gjendet vetëm 500 m, nga qendra e Deçanit, në rrugën e Manastirit të Deçanit është pikë orientuese e turistëve që vizitojnë trashëgiminë natyrore dhe kulturore të Komunës së Deçanit. Kjo zyre ofron edhe materiale të ndryshme si broshura dhe udhëzues të ndryshëm që turistët ta kenë më të lehtë qasjen në trashëgiminë kulturore dhe natyrore të Komunës së Deçanit, mundësinë e shfrytëzimit, akomodimit dhe ushqimit në lokalitete të ndryshme që i përkasin kësaj zone. Puna në këtë zyrë organizohet dhe drejtohet prej zyrtarëve komunal përgjegjës, të cilët kryejnë punë në bazë të programit të tyre vjetor si: zhvillimin e politikave të turizmit të qëndrueshëm, hulumtimet e produkteve turistike,

përpunimin e të dhënave të nevojshme për turizëm, hartimin e projekteve për zhvillimin e turizmit në Komunën e Deçanit, përgatitjen e materialeve promovuese, si dhe promovimin e Bjeshkëve të Deçanit, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Qendra Turistike Informuese, bënë edhe shpërndarjen e informatave për turistët si dhe shërbehen ata me harta, broshura, fletushka me fotografi të ndryshme, fletushka me informacione për florën dhe faunën, broshura të shtigjeve për ecje malore, udhërrëfyes për ndërtesat e trashëgimisë kulturore dhe gastronominë.



Foto 14 – 15. Qendra Rinore dhe Qendra Informuese turistike / foto e huazuar nga visit Deçani/

3.6. Trashëgimia natyrore

Komuna e Deçanit, është e njohur me trashëgimi natyrore ku një pjesë e kësaj pasurie është nën mbrojtje ligjore. Disa nga zonat e mbrojtura të natyrës në territorin e Komunës së Deçanit, datojnë që nga vitet e '50 të shekullit të kaluar. Sipas listes së trashëgimisë natyrore në Komunën e Deçanit egzistojnë gjithsej 27 zona të mbrojtura të cilat përbëhen nga 3 rezervate natyrore, 1 park kombëtar, 1 zone e veçantë e mbrojtur e natyrës, 1 park i natyrës, 19 monumente të natyrës dhe 2 pejsazhe. Parku Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” e zënë 26% të sipërfaqes së Komunes së Deçanit ose 16765.45 ha dhe trajtohet me Planin Hapësinorë për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”, kurse në përgjithësi, 17758.07 ha janë sipërfaqe me trashëgimi natyrore në Komunën e Deçanit.

Rezervatet natyrore - në Komunën e Deçanit janë Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna - Maja e Ropsit i shpallur në mbrojtje në vitin 1955; Parkut Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – Kozhnjeri i shpallur në mbrojtje në vitin 1955, Parku Kombëtar Bjeshkët e Nemuna – Malet e Preilepit të shpallura në mbrojtje në vitin 1963. Sipërfaqja e përgjithshme e rezervateve të natyrës në Komunën e Deçanit është 186.92 ha.

Rezervati natyror Maja e Ropsit, me sipërfaqe 25 ha, është vendë në mbrojtje në vitin 1955 me Nr.277/55 dhe ka rëndësi botanike me llojet e ruajtura të molikës, bredhit, pishës, ahut etj. Rezervati natyror Kozhnjeri me sipërfaqe 161 ha, është vendë në mbrojtje në vitin 1955 me Nr.337/58 dhe ka rëndësi faunistike gjegjësisht është rezervat ku jeton dhia e egër

(*Rupicarpa rupicarpa*). Rezervati natyror malet e Prilepit me sipërfaqe 0.92 ha, është vënë në mbrojtje në vitin 1963 me Nr 05/6/9/63 dhe ka rëndësi botanike me përbërje të pastër të panjës malore (*Accer Heildreichii*). Zonat e Veçanta të Mbrojtura - në Komunën e Deçanit janë të rregulluara me Ligjin Zonat e Veçanta të Mbrojtura - Ligji nr. 03/L-039 e cila siguron Mbrojtjen e Manastireve Ortodokse Serbe, e që në këtë rast është Manastiri i Deçanit i cili shtrihet në një sipërfaqe prej 800 ha, dhe Zona e Vecant e Mbrojtur Pishat e Deçanit e shpallur nën mbrojtje në vitin 1968 dhe ka sipërfaqe prej 15 ha.




Foto 16. Bukurit e bjeshkës së Deçanit / foto e huazuar nga visit Deçani/

Monumentet natyrore - në Komunën e Deçanit, kanë karakter: botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik po ashtu duke i përfshirë edhe peizazhet e ndryshme natyrore, që gjenden në gjithë territorin e komunës, dhe konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore. Instituti për Mbrojtjen e Natyrës (Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit) ka bërë hulumtimin dhe evidentimin e vlerave të reja të natyrës. Përveq vlerave të natyrës të mbrojtura paraprakisht, gjatë procesit të evidentimit të vlerave natyrore në territorin e Komunës së Deçanit, janë identifikuar edhe 19 vlera të reja, disa prej të cilave për shkak të vlerave unike janë të mbrojtura në mënyrë institucionale.

- Isniq – Bliri (1968)
- Isniq - Trungjet e Blirit (1968)
- Llukë e Ulët - Glleni i Llukës
- Kodrali - Trungu i Blirit
- Kodrali – Trungu bungëbutes
- Strelle i ulët – Trungu i Blirit
- Strelle i epërm – Trungu i Blirit

- Deçan – Burimi i ujit mineral
- Deçan – Trungu i Blirit
- Maznik – Trungu i Dushkut
- Dashinoc – Trungu i Dushkut, Ratishë e ulët – Trungu i Mrizit (bungut)
- Ratishë e epërm - Trungu i Dushkut
- Ratishë i epërm – Kompleksi i trungjeve
- Shaptei – Kompleksi i trungjeve të dushkut
- Gramaqel – Kompleksi i trungjeve – Varrezat e Jagozit.
- Carrabreg i Epërm – Trungu i Dushkut
- Drenoc – Trungjet e blirit dhe treungu u pishës
- Rastavicë – Trungu i Dushkut.

3.7. Trashëgimia kulturore

Popullsia e Komunës së Deçanit, sa i përket religjionit është e ndarë në tri besime kryesore dhe atë myslimane, katolike dhe ortodokse. Pjesa më e madhe e popullsisë i takon besimit mysliman, përderisa një numër i vogël i popullsisë i takojnë besimit katolik dhe ortodoks. Konsiderohet se rreth 96% e popullsisë në Komunën e Deçanit, i takojnë besimit mysliman, 3% i takojnë besimit katolik dhe 1% besimit ortodoks. Ndërtesat e kulte fetare janë të shpërndara në gjithë territorin e Komunës së Deçanit. Numri total i xhamive është 17, ortodokse është Manastiri i Deçanit i mbrojtur nga UNESCO (Trashëgimi Botërore), Kisha Katolike në fshatin Papiq dhe dy Teqe në fshatin Korali dhe Baballoq.

Varrezat, janë prezentë në Qytetin e Deçanit dhe në fshatrat e komunës të ndara në varreza të popullatës së besimit: Mysliman, Katolik dhe Ortodoks. Në disa fshatra hasen varreza të shpërndara në më shumë se një hapësirë të ndryshme dhe janë në prona publike, infrastruktura rrugore deri te varrezat ekziston ndërsa sa i përket ndërtesave përcjellëse për kryerjen e shërbimeve të varrimit në disa vende janë prezentë, por që në shumicën e vendeve mungojnë.



Foto 17-18. Trashëgimia kulturore (Kulla në fshatin Drenoc dhe Isniq) / foto e huazuar nga visit Deçani/

Komuna e Deçanit identifikohet me zona arkeologjike, komplekse, shtëpi tradicionale, kulla, xhami, kisha, mulli etj. Vendet më interes të madh janë lokalitet arkeologjike parahistorike, monumentet e kultit sic janë ato krishtere, islame, ortodokse, si dhe mullinjtë. Egziston një numër i madh i kullave dhe komplekse të kullave siç janë kompleksi i kullave në fshatin Isniq dhe Drenoc. Ndër kullat më të njohura janë Kulla e Osdautajve, Kulla e Kuklecve, Kulla e Demukajve, Kulla e Mushkolajve, Kulla e Mazrekajve, Kulla e Binakajve, Kulla e Ramë Shabanit dhe Kulla e Ali (Demë) Gecit të gjitha të ndërtuara nga fundi i shek. XIX.

3.8. Bujqësia

Komuna e Deçanit, është komunë ku pjesa dërmuese e popullsisë jeton në zonat rurale ku në zonat rurale jetojnë rreth 74.19% e popullsisë së tërësishme të Komunës së Deçanit. Bujqësia është veprimtari kyç në këtë trevë nga e cila sigurojnë të ardhura mbi 65% të banorëve të Komunës së Deçanit. Ekzistojnë kushte specifike që e favorizojnë bujqësinë dhe prodhimin e rendimenteve të kualitetit të lartë. Prodhimtaria bujqësore është orientuar në: prodhimtarinë bimore, prodhimtarinë blegtorale, shpendari, bletari dhe peshkatari. Komuna e Deçanit, ka resurse të konsiderueshme që mundësojnë zhvillimin e bujqësisë, gjithashtu ka fond të konsiderueshëm edhe të tokës bujqësore.



Figura 19. Dhënja e subvencioneve për fermerë

Sipërfaqja e territorit të komunës : Komuna e Deçanit shtrihet në një sipërfaqe prej 297 km² ose 29700 ha dhe përfshinë : 8.940.40ha tokë bujqësore, prej tyre kullosa 19%, 14.420 ha tokë pjellore 31% dhe 5.479.6 apo 50% ha pyje.

Në zhvillimin e bujqësisë kontribuojnë edhe ekspertët dhe teknikët e bujqësisë, ku në këtë komunë janë mbi 45 agronom të diplomuar dhe afër 200 teknik të bujqësisë të cilët ndihmojnë me këshilla profesionale dhe punë të drejtpërdrejtë. Në vitin 2023 janë identifikuar 10 ndërmarrje bujqësore dhe 361 ferma familjare që krahasuar me vitin 2013 kur në këtë komunë ishin 25 ndërmarrje private bujqësore, në vitin 2023 ekzistojnë vetëm 10 të tilla.

Territori i Komunës Deçanit karakterizohet me pjesën malore dhe e pasur me flore dhe faune si dhe me pjesën e rrafshët e cila karakterizohet me tokë kualitative dhe produktive të tokës bujqësore/sipërfaqe, tokë e punueshme/arë, kopshte, livadhe dhe tokë bujqësore e pa përdorur e që përfshinë 60% të sipërfaqes së tërësishme të Komunës së Deçanit prej (293,94 km²). Ndër to më se shumti ka tokë të mirë të klasës I, II dhe III me (60%) sipërfaqe ndërsa ma së paku tokë të varfër respektivisht klasa V, VI me (15%) sipërfaqe. Tokë të mesme të

kualitetit IV ka 25% të sipërfaqes kurse sa i përket bonitetit të tokës më se shumti ka të klasës 6 me 12094 ha, pastaj klasa 4 me 6501 ha, klasa 8 me 3204 ha dhe kështu me radhë.

3.8.1. Lavërtaria me Perimekulturë

Në bazë të dhënave nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural sektori i pemtarisë ka rritje të sipërfaqeve me trupa pemëve të mbjellura. Mollët dhe kumbullat janë kultura më të shpeshta që kultivohen nga ekonomia bujqësore, me gjithsej 65% mollë dhe 15% kumbulla nga totali i sipërfaqeve të mbjellura në tokë të punueshme kurse pjesa prej 20 % me kultura të tjera (arra, dardha, qershia/vishnje, ftua) etj. Shumica e këtyre kulturave bujqësore janë të kultivuara në kopshtet e shtëpive dhe me kultivim ekstenziv, ndërsa vitet e fundit kanë filluar me kultivim intenziv.

Sa i përket perimtarisë, në komunën e Deçanit prodhimtaria në secilën prej kulturave të perimeve ka shënuar rritje në vitet e fundit. Kulturat që më së shumti kultivohet në këtë veprimtari bujqësore janë: speci 31%, domatja 16%, trangujt 11% dhe qepët 20%, lakër 15%, të tjera 7%. Këto kultura paraqesin sipërfaqet e mbjellura me perime në komunën e Deçanit, të cilat ashtu si kulturat e perimeve kryesisht kultivohen në mënyë ekstenzive për nevojat familjare.

3.8.2. Pemëtaria

Prodhimtaria bujqësore e pemëtarisë – kanë gjetur treg të mjaftueshëm në produktet e caktuara siç është kultivimi i mollës, dardhës dhe arrave që janë në rritje dhe karakterizohen si produkte mjaft kualitative vendore me theks te veçantë “Arrat e Deçanit” ndërsa gjendja e prodhimit të dredhëzave dhe kumbullës në vitet e fundit është karakterizuar me rënje të prodhimit.

3.8.3. Blegtoria

Vlerësimi i zhvillimit të blegtorisë në të ardhmen përfshinë marrjen në konsideratë të një sërë faktorësh që ndikojnë në industrinë e blegtorisë. Llogaritet se vitet e fundit ka rritje të fondit blegtoral dhe prodhimtari të qumështit, në baza vjetore. Fermat e vogla janë zvogëluar, ndërsa kemi rritje të fermave të mëdha.

Prodhimi i qumështit - në Komunën e Deçanit, ekzistojnë dy pika grumbulluese për qumështin, ndërsa nuk ka pikë grumbulluese dhe përpunuese të prodhimeve bujqësore, kështu që fermerët janë të detyruar që tepricën e prodhimeve të tyre ta tregtojnë në tregjet tjera të Kosovës. Në Komunën e Deçanit, ekzistojnë 82 ferma të mëdha blegtorale/qumështore, nga këto ferma në baza vjetore prodhohen qumësht mbi 3.500.000 litra qumësht. Nga ky prodhim i raportuar, Komuna e Deçanit, llogaritet komuna e tretë me prodhimtari qumështore në Kosovë.



Foto 20. Organizimi i ditës së qethave të deleve / foto nga GLV-Gjeravica/

Prodhimi i mishit - Në zonat rurale infrastruktura bujqësore kërkon investime për ngritjen e kapaciteteve për prodhime bujqësore. Sipërfaqet e konsiderueshme të kullësive dhe livadheve janë potencial i rëndësishëm i Komunesë së Deçanit, për zhvillimin e blegtorisë e cila në veçanti shtrihet në pjesën rurale. Nga prodhimet blegtorale përpos qumështit, rëndësi është edhe prodhimi i mishit. Edhe sektori i prodhimit të mishit ka pësuar luhatje nga viti në vit ku krahasuar me vitin 2011 prodhimi i mishit në vitin 2023, ka trend të rënjes për 32.14% të mishit të deles ose me prodhim 19 ton, dhe 3.33% ose me prodhim 696 ton të mishit të gjedhit, e në total 35.48% prodhim më pak se në vitin 2011.

Gjedhet - nga viti 2011 deri në vitin 2023 ka një rritje të ndjeshme në përgjithësi mirëpo sa i përket llojeve ku duhet të cekët se nga 3400 krerë lope në vitin 2011 ka rënie në 2397 krerë në vitin 2023. Sa i përket mëshqerrave këtu dallohet një trend i rritjes gjegjësisht nga 600 krerë vitin 2011 në 882 në vitin 2023.

Delet - nga viti 2011 deri në vitin 2023 karakterizohet me rënie të numrit të krerëve sa i përket deleve mbarështimi kur në vitin 2011 ishin 3099 ndërsa në vitin 2023 2397. Gjendja e njëjtë është edhe me qengja kur në vitin 2011 ishin 4022 krerë ndërsa në vitin 2023 gjithsejtë 790 krerë. Trendi i deleve në vitin 2023 në krahasim me vitin 2011 është në rënie të madhe.

Dhitë –kanë një trend më pozitiv sa i përket koncentrimit të tyre në Komunën e Deçanit. Cjapi ka rritje nga 32 sa i shihet në vitin 2011 në 53 të tilla sa janë në vitin 2023. Ndërsa gjendja e dhive ka trend negativ gjegjësisht nga 184 të tilla sa ishin në vitin 2011 ndërsa sipas të dhënave në vitin 2023 janë gjithsejtë 172 të tilla. Mirëpo trendi i dhive në përgjithësi mund të konsiderohet si trend me rritje pozitive.

3.9. Bletaria

Një prej sektorëve me profitabil në fushën e bujqësisë është edhe bletaria. Komuna e Deçanit ka një pozitë të volitshme gjeografike për kultivimin e bletarisë. Aktualisht, në komunën e

Deçanit llogaritet të jenë mbi 200 bletar me 10,000 koshere bletë. Ky sektor është përkrahur nga komuna në formën e rritjes së numrit të koshereve dhe bletarëve (pajisje) me gjithë përkrahjen nga komuna bletarët nuk kanë arritur të zhvillohen për sa i përket rritjes së numrit të produkteve të bletës, si p.sh. propolis, qumështi i bletës, poleni, etj. Bletarët janë organizuar nëpërmjet shoqatës së Bletarëve, ku herë pas here mbajnë trajnime dhe ligjerata për bletarët e rinjë mbi kultivimin e bletëve. Megjithatë, edukimi i bletarëve edhe më tutje mbetet sfidë komunës dhe Shoqatës së Bletarëve, sidomos në kontrollin dhe menaxhimin e sëmundjeve të bletëve. Regjistrimi i bletishteve, krijimi i pasaportës së bletës, lokalizimi i bletishtëve, kultivimi i bimëve mjaltë-dhënëse dhe përpilimi dhe monitorimi i listës së sigurtë të barnave për bletët, mbetet edhe më tutje sfidë për bletarët, Shoqatën e Bletarëve dhe komunën e Deçanit.



Foto 21. Bletishtë e organizuar / foto nga GLV-Gjeravica/

3.10. Pylltaria

Pyjet e Komunës së Deçanit, janë thesari i çmuar i vendit duke ju falënderuar relievit, klimës dhe hidrografisë që i bënë ato dhe me atraktive. Në përgjithësi janë 15281 ha pyje nga të cilat 37% ose 5711 ha tokë pyjore private ndërsa 63% janë tokë pyjore shoqërore ose 9570 ha. Për nga kategoria janë tokë pyjore e shfrytëzuar për qëllime komerciale e cila nga viti 2011 sa ishte 582 ha në vitin 2023 ka pas rritje në 5711 ha. Tokë pyjore e mbrojtur në vitin 2011 nuk ishte fare mirëpo pas shpalljes së Parkut Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna”, sipërfaqja e tokës pyjore të mbrojtur është rritur në 16765 ha ose në total 22476 ha.



Foto 22. Pejsazhe të bukura të pyjeve të Deçanit / foto e huazuar nga Deçani ynë/

Nga sipërfaqja totale e tokës pyjore në Komunën e Deçanit, tokë pyjore halore janë 8489,9 ha kurse tokë pyjore gjetherënëse 6946,6 ha. Pyjet shtrihen në lartësi të larta mbidetare, pika më e lartë është Gjeravica 2656 m , ndërsa pika më e ulët mbidetare është në Podin e Gështenjave. Ato janë burim kryesorë për prodhimin e biomasës tokësore dhe furnizuesi kryesorë me oksigjen, ku ruajnë tokën nga erozioni, erërat etj. Pjesa më e madhe e pyjeve të Komunës së Deçanit, është në pronësi publike, në viset e ulëta dominojnë pyjet e dushkut të cilat dita ditës po degradohen në mënyra të ndryshme, ndërsa në viset malore më të larta janë pyjet e pastra të ahut dhe halorëve (pishave) të ndryshme. Pyjet e Deçanit, janë jashtëzakonisht atraktive dhe ideale për vizitë turistike dhe për një pushim malorë. Pyjet e Komunës së Deçanit, kanë ndikim të madh në natyrë nëpërmjet procesit të fotosintezës, fletët dhe halat e drurëve CO₂ (dyoksidi i karbonit) atmosferik konvertohet në karbon të ngurtë të depozituara në biomasë. Biomasa pyjore për prodhimin e energjisë përfshin drutë e zjarrit, mbetjet që rezultojnë nga procesi i shfrytëzimit (maja, degë, lëvore) dhe mbetjet e procesit të përpunimit industrial të drurit si tallash, ashkla etj. Harmonizimi i kërkesës dhe ofertës për dru zjarri dhe lëndë punimi ka qenë dhe mbetet një sfidë për ekonominë pyjore ndër vite. Vlen të theksohet se Pyjet në Komunën e Deçanit janë teje mase të pasuruara me Gështenjë apo “Pema e Bukës” siç njihet në këtë anë. Në bazë të dhënave vetëm në Komunën e Deçanit janë rreth 900 ha me Gështenjë, 80% e tyre në pronë shtetërore dhe 20% pronë private. Gështenja përpos vlerave të saja ushqyese mund të gjejë vend edhe në shumë prodhime industriale, e që për Komunën e Deçanit është edhe pasuri por edhe mundësi për zhvillim.

3.11. Ujësjellësi dhe kanalizimi

Ujësjellësi - Sistemi i furnizimit me ujë në Komunën e Deçanit, menaxhohet nga K.R.U “Hidrodrini” SH.A Pejë⁵ - Njësia shërbyese Deçan, kurse furnizimi për qytetin dhe fshatrat e Komunës së Deçanit janë të gjitha burime nëntokësore si më poshtë:

- Bjeshka e Strellcit përfshinë 6 burime
- Gryka e Deçanit përfshinë 5 burime
- Gryka e Deçanit - Gypi i CDF-së - përfshinë 3 burime
- Bjeshka e Lloqanit përfshinë 3 burime
- Burimi Gjipsi i Vokshit dhe Lugu i Zallit përfshinë 5 burime
- Burimi Hulaj përfshinë 1 burim
- Burimi Isniqit përfshinë 2 burime

Qyteti i Deçanit i ka 37 fshatra, ku 35 fshatra mbulohen me rrjetin e ujësjellësit me furnizim 99 % me ujë të pijes, ndërsa fshatrat Belle dhe Pleqe furnizohen nga burimet natyrore për shkak të konfigurimit të terrenit malor. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Komunën e Deçanit, janë 40019 banorë, të cilët kanë qasje në sistemin e ujësjellësit 99.9%, ku numri i konsumatorëve në Komunën e Deçanit ishte 6472, nga amvisëria 6011, klient komerciale 414 dhe klient institucional 4739. Në vitin 2023 të dhënat tregojnë për shtimin e numrit të konsumatorëve gjegjësisht të lidhjeve në rrjetin e ujësjellësit për 18 konsumatorë të ri ose 6946 konsumator nga të cilët 6490 janë amvisëri, 407 klient komercial dhe 49 klient publik. Sipas K.R.U “Hidrodrini” Pejë – Njësia shërbyese Deçan, gjatë një vitit shpenzohen 1110010 m³ për amvisëri ose me një mesatare prej 0.46 m³ në ditë; për klient komercial 85719 m³ ose me një mesatare prej 4.79 m³ ; dhe 59827 m³ në vit për klient publik ose mesatarisht 0.4 m³ në ditë. Totali i konsumit të ujit të pijshëm në Komunën e Deçanit është 1,255,556 m³.

Burimet e ujit të pijshëm janë nga 7 pika me gjithsejtë 25 burime ku Burimi Gryka e Deçanit e me 5 burime furnizon me më se shumti me ujë të pijshëm me gjithsejtë kapacitet prej 66.44 L/s, ndërsa burimi Gjipsi i Vokshi dhe Lugu i Zallit me 5 burime furnizojnë më së paku me ujë të pijshëm me kapacitet prej 27 l/s. Në përgjithësi, në Komunën e Deçanit furnizohen me ujë të pijshëm 99 % e banorëve në 24 h dhe atë me një sasi prej 305.44 l/s.

Sipas projeksioneve për 8 vitet e ardhshme të furnizimit me ujë të pijshëm për amvisëri, klient komercial dhe klient publik planifikohet se rritja e vëllimit me ujë të pijshëm është 1413 m³ më shumë se viti 2023. Sipas, kapaciteteve ekzistuese, kjo sasi e kërkesës për ujë të pijshëm është e përballueshme në përjashtim të periudhës së verës ku duhet të menaxhohet përdorimi i ujit të pijshëm, e cila është në varësi me temperaturat e larta dhe reshjet atmosferike.

Kanalizimi - Në Komunën e Deçanit, sistemi i kanalizimit ka filluar të ndërtohet që nga viti 2007, dhe ende vazhdon shtrirja e rrjetit deri në kompletimin e tij final. Rrejtja e kanalizimit fekal në Komunën e Deçanit e mbulon vetëm 45% të territorit komunal. Investimet në këtë fushë janë të vazhdueshme mirëpo duhet edhe disa vite në vazhdim që rrjeti i kanalizimit fekal të përfundojë në tërësi.

Menaxhimi i rrjetit të ujërave të zeza bëhet nga K.R.U “Hidrodrini” Pejë – Njësia operative Deçan. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të kanalizimit fekal është 64 572,36 m si dhe derdhja

⁵ Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032

bëhet në 8 gropa septike kolektive në lokacione të ndryshme. Kjo gjatësi e shtrirjes së këtij rrjeti të kanalizimit mbulon një sipërfaqe prej 321 ha të vendbanimeve në Komunën e Deçanit të shpërndara në 15 lokalitete dhe me sipërfaqe të ndryshme. Sipërfaqja më e madhe e shtrirjes së mbulueshmërisë me rrjetin e kanalizimit të ujërave të zeza është Deçani me 78.9 ha ndërsa ajo më e vogla me sipërfaqe Sllupi me 10 ha. Gjerësia e zonës mbrojtëse shkon nga 3m deri në 15m ndërsa vjetërsia mesatare e të gjithë gropave septike kolektive është 16.8 vjet. Rrjeti primar i kanalizimit fekal ka një gjatësi të përgjithshme prej 44841.72 km të dixhitalizuar, me material PVC SN8 me profile prej Ø 200 deri te Ø 1000, kurse është duke u vazhduar edhe në dixhitalizimin e pjesës së mbetur nga kompania menaxhuese. Rrjeti sekondar i kanalizimit fekal ka gjatësi të përgjithshme prej 11340.48 km, me material PVC SN8 me profile prej Ø 200 deri te Ø 350.

Në Komunën e Deçanit, ekziston rrjeti i kanalizimit për largimin e ujërave atmosferik i cili derdhet në drejtim të lumit të Lumëbardhit dhe i cili nuk ka trajtim. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të kanalizimit atmosferik është 6500 metra ose 6.5 km, me material PVC SN78 me diametër - Ø 500 ndërsa vjetërsia e rrjetit atmosferik shkon nga 3 deri 13 vjet.

Kanalizim i ujërave atmosferik⁶ është i shtrirë kryesisht në zonën urbane dhe shumë pak në zonat rurale ku deri më tani janë vetëm 6.5 km të rrjetit të ujërave atmosferik të shtrira kryesisht në zonën urbane por pjesërisht edhe në zonat rurale gjegjësisht me shtrimin dhe rregullimin e një pjese të rrugës R107 - pjesa hyrëse nga pjesa veriore. Në periudhën 8 vjeçare planifikohet të shtohen edhe 2,5 km të rrjetit atmosferik gjegjësisht deri të vendbanimi Strellc i Epërm si dhe 6 km tjera në drejtim të zgjerimit të rrugës deri në kufirin me Gjakovën.

3.12. Ujitja

Sistemi i ujitjes në Komunën e Deçanit, administrohet nga Kompania Rajonale e Ujitjes (KRU) “Drini i Bardhë” Pejë. Gjatësia e sistemit të ujitjes aktual është prej 61.110 m, ndërsa gjendja fizike e rrjetit është e mirë. Në infrastrukturën e ujitjes janë ndërtuar 8 penda, ose prita të ujit-furnizues për furnizim të kanaleve të ujitjes. Një pjesë e sistemit të ujitjes është tradicional, “Ujitje me Përmbajtje”, që bëhet përmes kanaleve të hapura dhe përfaqëson mënyrën e ujitjes me shpenzime maksimale të ujit. Kjo paraqet problem, në veçanti gjatë muajve korrik - gusht kur sasia e ujit është e pamjaftueshme në mungesë të reshurave dhe temperaturave të larta. Për krijimin e kushteve të mira për ujitjen e tokave bujqësore, komuna ka studimin e fizibilitetit për ndërtimin e tri pendave akumuluese në kanjonin e lumit të Lumëbardhit të Lloqanit.

Për ujitje në territorin e komunës, shfrytëzohen disa burime natyrore siç janë lumenjtë dhe pusët (bunarët). Duke qenë se nuk ka një sistem të rregulluar të ujitjes sipas të dhënave sipërfaqet dhe sasitë e nevojshme për ujë nuk mund të verifikohet me saktësi, por supozohet se janë diku rreth 80 % e sipërfaqes së tokës bujqësore që mbulohet me ujitje. Komuna e Deçanit, ka një infrastrukturë të mirë për ujitjen e tokës bujqësore ku deri më tani kanale të betonuara janë gjithsej 61,110 m, por në të ardhmen për zhvillimin dhe rritjen e prodhimtarisë bujqësore investimet e komunës do të përqendrohen në ndërtimin e infrastrukturës bujqësore.

⁶ Plani Zhvillimor Komuna 2024-2032

Komuna e Deçanit, duke u bazuar në projekt Planin Zhvillimor Komunal, ka identifikuar domosdoshmërinë për ndërtimin e kanaleve të ujitjes në zonat rurale, ku janë identifikuar të gjitha kanalet e ujitjes që duhet të ndërtohen. Ndërtimi i kanaleve, do të ujitë rreth 4302 ha tokë punuese, ku rreth 60% e kësaj sipërfaqe është e mbjellë me perime dhe pemishte intensive. Andaj është e një rëndësie të veçantë ndërtimi i këtyre kanaleve për rritjen e rendimenteve të të gjitha kulturave bujqësore. Në Komunën e Deçanit në ndërtim janë 32 kanale me gjatësi rreth 51.2 km si dhe 3 penda ujitëse që planifikohen të ndërtohen në të ardhmen në Lumëbardhin e Lloqanit.

3.13. Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Në Komunën e Deçanit ndodhet një njësi deponuese për mbeturina e cila ka sipërfaqe 4ha me zonë mbrojtëse 100m ndërsa stacioni transferues është në njësinë deponuese në Sverkë në Komunën e Klinës e cila ka sipërfaqe 130 ha dhe zonë mbrojtëse 800 m.

Komuna e Deçanit, ka krijuar një sistem komunal për menaxhim të mbeturinave dhe plotësimin me mjetet përcjellëse për shtrirjen e plotë të shërbimit për mbledhjen (grumbullim) të mbeturinave në gjithë territorin e komunës. Shtrirja e menaxhimit të mbeturinave në gjithë komunën, bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale “Higjiena” Sh. A. e cila ofron shërbime rreth mbledhjes (grumbullimit) të mbeturinave dhe ndarjes në bazë në ekonomitë familjare në 38 vendbanimet e Komunës së Deçanit. Trajtimi i mbeturinave përfshin: riciklimin, ripërdorimin, reduktimin dhe kompostimin e mbeturinave e deri në transportimin e tyre në deponinë regjionale. NPL “Higjiena” Sh. A, mbështetet nga GIZ-i Gjerman në kuadër të projektit “Shërbimet të Qëndrueshme Komunale”, siç janë përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-060 Për Mbeturina. Kjo ndërmarrje e bënë mbledhjen (grumbullimin) e mbeturinave duke afruar shërbimin “Derë me derë” për ekonomitë familjare në zonën e qytetit të Deçanit, dhe mbulon në mbledhjen e mbeturinave zonën urbane të qytetit duke u shtrirë edhe në mbledhjen e mbeturinave edhe në 35 fshatra të komunës. Dy vendbanime siç janë: fshati Belle dhe Pleqe, sipas konfiguracionit malor ofrohet shërbim sipas Planit Komunal për Menaxhim të Mbeturinave në Komunën e Deçanit. Në Komunën e Deçanit, janë të përfshira: 7681 ekonomi familjare, 584 biznese aktive dhe 22 klient publik dhe klient me kontratë, ku mbulimi me shërbim është 100% në gjithë territorin e komunës. Shërbimi “Derë më derë” kryhet nëpërmes kontejnerëve 120 litershe dhe qese plastike dhe i njëjti bëhet duke ofruar shërbim për qytetin dhe të gjitha fshatrat. Ndërsa shërbimi me kontejnerë të përbashkët (në pjesën e qendrës së qytetit) dhe me kontratë kryhet nëpërmes kontejnerëve 1.1m³. Në Komunën e Deçanit ndodhet njësi deponuese e cila ka sipërfaqe prej 4 ha dhe më zonë mbrojtëse prej 100 m. Ndërsa njësi transferuese është në Sverkë (Komuna e Klinës) me sipërfaqe prej 140 ha dhe zonë mbrojtëse 800 m.

3.14. Institucionet kulturore dhe rinore

Në Komunën e Deçanit funksionojnë dy Shtëpi të Kulturës, njëra në Deçan dhe tjetra në Isniq si dhe një Muze në Deçan dhe një muze privat i njohur si “Etno-Kastrioti” në fshatin Isniq. Shtëpia e Kulturës “Jusuf Gërvalla” – është hapësirë shumë funksionale me etazhitet B+P+1K+NK e ndërtuar në një sipërfaqe prej 2100 m² në bazë dhe sipërfaqe shfrytëzuese të gjitha etazhave prej 8500 m². Në këtë shtëpi të kulturës janë: Galeria e arteve – Ars Kultura,

biblioteka (salla ekspozuese, sallat e leximit), salla audio-vizuale, hapësirë e siguruar për media-radio. Po ashtu një etazhë e objektit është vënë në dispozicion të shoqatave dhe klubeve të ndryshme kulturore-artistike të cilat veprojnë në Deçan, inkubatori i bizneseve, Qendra për Regjistrim të Bizneseve, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër si dhe KKZ. Teatri i qytetit “Skënder Tafaj”- i cili gjendet në Pallatin e Kulturës në Deçan, i përmbushë nevojat për shfaqje si: drama, komedi, filma si dhe aktivitete tjera kulturore (muzikës). Biblioteka e komunës, i plotëson kushtet por duhet të bëhet ndërhyrje në gjithë hapësirën për ofrimin e kushteve me të mira për lexuesit, duke përfshirë si: inventarizimin e librave, pasurimin me tituj të rinj të librave të autorëve të vendit dhe të huaj. Shtëpia Kulturës “Berit Backer” e cila gjendet në fshatin Isniq, e ka marr emrin e veprimtares e cila ka qenë një antropologe dhe aktiviste për të drejtat e njeriut e cila bashkë me fotografen Ann Christine Eek, në vitin 1976 bëri një udhëtim në Kosovë, për ta dokumentuar jetën rurale në fshatin Isniq.

Në Komunën e Deçanit janë të ndërtuara Palestra Sportive dhe Stadiumi i qytetit Ruzhdi Ramosaj. Palestra është ndërtuar në vitin 2013 ndërsa stadiumi në vitin 2015. Të dy këto institucione të sportit i shërbejnë të gjithë banorëve të Komunës Deçanit.

Jeta kulturore në Komunën e Deçanit, është e pasur me një numër të madh të aktiviteteve dhe natyrave të ndryshme, duke filluar nga ato kulturore dhe sportive. Të gjitha këto aktivitete kulturore-sportive zhvillohen dhe organizohen në ndërtesa të kulturës. Kultura tregon të kaluarën dhe të tashmen e një populli të cilën banorët e Komunës së Deçanit, e kanë dëshmuar me evenimentet e ndryshme kulturore dhe tradicionale. Zhvillimet kulturore kanë zënë vend që një kohë të gjatë.

Në Komunën e Deçanit, veprojnë këto grupe artistike: Ansambli Artistik i Këngëve dhe Valleve i Deçanit, Shoqëria kulturo-artistike “Jusuf Gërvalla”, grupi i rapsodëve “Dervish Shaqa”.

3.15. Hapësirat publike dhe të gjelbra

Ekzistojnë disa sheshe dhe parqe të cilat frekuentohen nga banorët dhe vizitorët mirëpo për zhvillimin e qytetit aktiv, duhet të hartohen politikat e qarta ku ekzistojnë gjithsejtë 3 parqe të njohura në Deçan dhe 7 sheshe. Parqet karakterizohen me llojllojshmëri të florës por edhe faunës ndërsa sheshet janë ma shumë si emërime se sa si hapësira të cilat janë të përshtatshme për frekuentim. Andaj është më se e nevojshme që të organizohen këto hapësira dhe të ridizajnohen duke ju caktuar kufirin e qartë të tyre. Hapësirat publike dhe të gjelbra përdoren për rekreacion aktiv dhe pasiv, ndërkohë që efektet e tyre të shumëfishta (shëndetësore, kulturore etj.) përmirësojnë cilësinë e jetës. Për të qenë në dispozicion të banorëve, hapësirat publike dhe zonat e gjelbra duhet të jenë të integruara mirë dhe të shpërndahen në mënyrë të barabartë në të gjitha hapësirat e pjesës urbane dhe rurale. Hapësirat publike dhe të gjelbra në zonën urbane janë duke u zvogëluar në mënyrë të vazhdueshme nga ndërtimet, po ashtu të njëjtat hapësira janë duke u rrezikuar nga presioni i ndërtimit. Në hapësirat ekzistuese qasja në ato është e mirë, për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimet emergjente. Përdoruesit janë nga të gjitha grup-moshat, kurse mirëmbajtja e tyre bëhet nga Ndërmarrja Publike Lokale Higjiena për gjatë gjithë vitit.

Hapësirat e gjelbra në Komunën e Deçanit janë të paketa mirëpo pozita gjeografike e qytetit të Deçanit pranë hyrjes në Parkun Kombëtarë “Bjeshkët e Nemuna” e bën këtë pjesë mjaft

atraktive. Ekzistojnë dy parqe kryesore në Deçan: Parku Pishat e Deçanit dhe Parku Luan Haradinaj dhe Sali Ceku. Gjithashtu ekzistojnë 6 sheshe të cilat ndodhen në vendbanimet Deçan, Isniq, Strellc i Epërm, Irzniq dhe Pobergjë si dhe shëtitorja në Deçan përgjatë dy brigjeve të lumit Lumbardh.

Numri i vend parkingjeve të organizuara në Komunën e Deçanit nuk janë të rregulluara në mënyrën e duhur. Vend parkingjet janë të organizuara vetëm në qytetin e Deçanit, ndërsa në vendbanimet rurale ato janë ma pak në numër dhe janë të organizuara kryesisht te institucionet e ndryshme (arsimore, sportive, rekreative, kulturore, administrative etj.)

3.16. Mjedisi

Mjedisi në Komunën e Deçanit ka përmirësime në vitet e fundit si rezultat i administrimit të mirë të mbeturinave, pastrimin e deponive ilegale, ndërtimin e rrjetit të kanalizimit për ujërat e zeza në pjesën rurale si dhe rritjen e sipërfaqeve gjelbëruese - shesheve dhe parqeve. Në Komunën e Deçanit nuk ka njësi matëse të cilat e monitorojnë rregullisht nivelin e ndotjes së ujërave të lumenjve, kanaleve, proçkave etj. Ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë në Komunën e Deçanit, i ekspozohen ndotjes nga shkarkimet e ndryshme qoftë nga bizneset dhe ekonomitë familjare.

Përdorimi i ujit nga bizneset dhe amvisëritë pa u trajtuar shkarkohen në shtratin e Lumëbardhit të Deçanit dhe Lumëbardhit të Lloqanit. Ujërat e ndotura (zeza) përmbajnë shumë lëndë që shpenzojnë oksigjenin e tretur, komponime të tretshme të fosforit dhe azotit, baktere dhe viruse patogjene, metale të rënda: Cd (kadmiumi), Hg (merkuri), Zn (zinku), Pb (plumbi), Cr (kromi) etj. si dhe materie tjera që prishin cilësinë e ujit ndikojnë në ndryshimin e parametrave fiziko-kimik dhe biologjikë të ujit. Nga burimi i tyre Lumëbardhi i Deçanit dhe Lumëbardhi i Lloqanit, janë të pastër dhe klasifikohen në kategorinë e parë për nga cilësia e ujit ngase janë larg vendbanimeve kur fillon rrjedhja e tyre të shtrihet nëpër vendbanime, hyn në kategorinë e dytë të cilësisë së ujërave pasi kalojnë nëpër vendbanime për shkak të shkarkimit të ujërave të ndotura (zeza) si dhe për shkak të hedhjes së mbeturinave të amvisërisë dhe inerte. Shkarkimi i ujërave të ndotura (zeza) në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumenjve.

Në Komunën e Deçanit, një prej shqetësimeve për humbjen e fondit të tokës bujqësore janë ndërtimet në tokën bujqësore ku është identifikuar sipërfaqja prej 200.75 ha tokë ndërtimore nga sipërfaqja e përgjithshme e komunës, prandaj çdo veprim që shkatërron veçoritë dhe cilësitë natyrore të kësaj hapësire jetike emërtohet degradim (ndotje e tokës). Shumica e faktorëve që krijojnë degradimin e tokës vijnë nga shkaqe të ndryshme nga faktori njeri, ku ndër më kryesoret janë:

- Ndotja e tokës nga mbeturinat e amvisërisë dhe mbeturinat inerte;
- Përdorimi pa kriter i preparateve kimikë;
- Erozionet që vijnë nga shkatërrimi i pyjeve.

Në Komunën e Deçanit, fatkeqësitë natyrore përbëjnë rrezik për jetën e njeriut, mjedisin, ndërtesat e trashëgimisë kulturore. Ato shfaqen në mënyra të ndryshme nëpërmjet

vërshimeve, tërmete, zjarre të pa kontrolluara, erërat e forta, erozionet, rrëshqitja e dheut etj.

Vërshimet janë fatkeqësi elementare që kërkojnë vëmendje të veçantë dhe janë dukuri që shfaqen në zonat e caktuara që janë të rrezikshme për jetën e njerëzve dhe shkaktojnë dëme materiale. Vërshimet, mund të parashikohen nëpërmes përdorimit të teknologjisë së avancuar dhe të merren masat paraprake për parandalimin ose uljen e dëmeve në jetë të njerëzve nëpërmes evakuimit.

Hedhja e mbeturinave në kanalet e hapura, procka dhe lumenjë ka ndikim të madh në ndotjen e ujërave. Gjithashtu përdorimi në mënyrë të pakontrolluar të pesticideve ka ndikuar në ndotjen e ujërave nëntokësore e që si efekt negativ mjaft bunarë janë bërë të pashfrytëzueshme. Punimet dhe ndërtimet në infrastrukturë të trafikut, teknike si dhe mungesa e reshjeve kanë ndikuar në lëvizjen e ujërave nëntokësore dhe si efekt negativ kanë ndikuar që ujërat e bunarëve të shteren.

3.17. Flora dhe Fauna

Territori i Komunës së Deçanit përfaqëson zonën shumë të pasur me pyje dhe me tipe tjera vegjetacioni⁷. Flora e kësaj treve radhitet në zonat më laramani përmbajtjesh vegjetative më të cilat bëjnë pjesë :

- **Gjethëramëset e fushave** : Janë bimë, të cilat i ka kultivuar dora e njeriut nëpër megja të arave dhe livadheve si: shëlg, verra, plepa, bagrena, vidha si dhe shumë llojshmëri e pemëve: molla, dardha, arra, etj.
- **Zona e gështenjave** : Nga Juniku deri në Strellc në lartësi mbidetare prej 100 deri 1000m dallohet zona e pasur me gështenja, ky lloji i pemëve ka rëndësi të madhe si nga fruti ashtu nga lënda drunore
- **Zona e pyjeve gjetherënëse** : Në lartësi deri në 1500m dallojmë pyjet gjetherënëse si bungu, ah, shkoza lajthija frashëri, panja etj. Shërbejnë si lëndë djegëse dhe në ndërtimtari.
- **Zona e pishnajave** : Në zonën e pishnajave paraqiten relikte dhe lloje endemike si: pisha e bardhë, pisha e zezë, bredhi i kuq, dhe bredhi i bardhë, molika etj. Këto lloje të drunjve kanë rëndësi të madhe si në ndërtimtari ashtu edhe në industri.
- **Zona e kullosave**: Mbi lartësitë 2000-2500m paraqitet zona e kullosave e cila është hapësirë shumë e përshtatshme për zhvillimin e blegtorisë. Kjo zonë është e pasur edhe me bimë mjekësore dhe më së shumti haset: boronica, pelini, lencuri, dhe të gjitha llojet çajit.
- **Zona e shkëmbinjve të zhveshur** : Ngjitur me zonën kullosave në lartësi mbi 2500m shtrihet zona e zhveshurë së cilës i mungon çdo lloji i vegjetacionit.

Fauna e Bjeshkëve të Nemuna paraqet një rezervat shumë të pasur me lloje të ndryshme të kafshëve të egra të cilat jetojnë në pyje të dendura si: ariu, ujku, dhelpra, lepuri, vjedulla,

⁷ Material i shfrytëzuar nga Plani Zhvillimor Komunal i Deçanit 2024-2032

derri i egër, reqebulli, kaprolli ,ketri ,etj si dhe një llojllojshmëri shumë e madhe e shtazëve që ndërtojnë fole të përhershme ose sezonale.

3.18. Pozita e fshatrave në zonën rurale

Vendbanimet në Komunën e Deçanit janë të ndarë në vendbanimet formale dhe jo formale. Vendbanimet formale janë vendbanimet formale urbane, vendbanimet formale rurale. Deçani është qendër administrative dhe politike për gjithë komunën. Në këtë vendbanim funksionon administrata komunale, strukturat udhëheqëse dhe politike, shërbimet kryesore shëndetësore, agjencionet, institucionet rajonale etj.

Përpos Deçanit, ekzistojnë edhe tre zyra tjera të vendit në Strellc i Epërm , Drenoc (Polana), ofrojnë shërbimet për qytetarë ndërsa Zyra e Gjendjes Civile në fshatin Irzniq, nuk është në funksion kurse shërbimet për këtë rajon ofrohen në objektin e Komunës së Deçanit.

Banimit në Komunën e Deçanit karakterizohet me ndërtime të ulëta me një tendencë të rritjes së etazhitetit në dhjetë vitet e fundit. Shtëpitë karakterizohen me një apo më shumë familje ose siç njihet jetesa në bashkësi. Pas luftës në Kosovë, tendencat e banimit kanë ndryshuar duke krijuar njësi të reja banimi për një familje dhe gradualisht duke u ndarë nga të jetuarit në bashkësi.

Tipologjia e vendbanimeve sipas madhësisë është e një rëndësie të veçantë nga se përmes kësaj metodologjie shihen qartë karakteristikat e sistemit të popullatës së hapësirës së caktuar si dhe mënyra e organizimit të jetës në vendbanimet e kësaj hapësire.

3.19. Arsimimi në lëmin e bujqësisë

Drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, organizon trajnime / ngritje të kapaciteteve/ nëpërmes projekteve që implementohet nga Ministria Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), po ashtu shumë projekte që implementohen nga donatorët të ndryshëm ndërkombtar dhe vendor. DBPZHR, përveq trajnimeve ndihmon fermerët e kësaj komune edhe gjatë aplikimit të fermerëve për pagesa direkte dhe këshilla për grante në nivelin qendror, nëse ka ndonjë kërkesë nga fermerët. Brenda kësaj drejtorie është edhe Qendra Informativ Këshilluese Komunale (QIKK) në bazë të memorandumit të bashkepunimit në mes të MBPZHR dhe të Komunave të nënshkruar gjatë vitit 2012 nga përfaqësuesit e Ministrisë dhe Kryetarëve të Komunave.

Selia e QIKK është brenda ndërtesës së komunës së Deçanit, gjegjësisht në divizionin e zhvillimit rural dhe bujqësisë siq u theksua më lartë. Aktiviteti kryesor i këtij shërbimi është këshillimi bujqësor. Këshillat bujqësore përbëhen nga ofrimi i këshillave profesionale, informatave dhe ndihmës për prodhuesit bujqësor për aspektet teknike dhe teknologjike, komerciale dhe marketingut, të organizative të prodhimit bujqësor, fermerëve dhe të tjera. Puna këshillimore bëhet përmes kontakteve të drejtpërdrejta me fermerët në fermë, me telefon dhe media.

4. SWOT ANALIZA LOKALE PËR ZHVILLIMIN RURAL NË KOMUNËN E DEÇANIT

Ashtu siç u tha edhe në fazën e metodologjisë, analiza SWOT është një metodë e përshtatshme dhe shumë frytdhënëse për identifikimin e prioriteteve dhe hartimin e një plani zhvillimor lokal. SWOT-i, paraqet në mënyrë të përmbledhur, pikat e forta dhe të dobëta të zonës së GLV-Gjeravica, duke u mbështetur në përshkrimin e burimeve si dhe mundësitë e rrethit. Nga rezultati i analizës SWOT, si dhe nga diskutimi i gjerë me përfaqësues të grupeve të interesit të zonës rurale të GLV - Gjeravica, u identifikuan disa drejtime kryesore për zhvillimin e strategjisë lokale. Gjatë takimeve me grupet tematike punuese kemi arritur në përfundim si më poshtë:

Përparësitë	Dobësitë
- Bjeshkët e Nemuna si pasuri natyrore me potencial të zhvillimit ekonomik në sektorin e turizmit; - Organizimi i festivaleve të ndryshme / Eshkë e ndezur mbi shkelzen/; - Qendra për Informim Turistik, dhe Qendra Rinore; - Kapacitetet e prodhimit bujqësorë dhe blegtorale në rritje; - Sipërfaqe të konsiderueshme të tokës bujqësore nën sistemin e ujitjes; - Organizimi i fermerëve në shoqata dhe grupe me interesa të përbashkëta; - Sipërfaqe natyrore me bimë mjekësore në Bjeshkët e Deçanit; - Përkrahja e fermerëve me subvencione të ndryshme, mekanizëm dhe lopë të races; - Korridori i lidhjes së Komunës së Deçanit me Malin e zi; - Rrjedha të bollshme të ujërave mbi dhe nëntokësore; - Mosha e re e popullsisë; - Traditë të gjatë në bujqësi ; - Pozitë të mirë për diversifikimin e bujqësisë; - Mosha e re e popullsisë; - Pozitë të mirë për diversifikimin e bujqësisë; - Bashkëpunimi regjional i GLV-ve;	- Shkalla e lartë e papunësisë; - Zhvillimi i dobët ekonomik (të ardhurat e vogla për kokë banori); - Ndotja e kanaleve të ujitjes dhe lumenjë; - Mungesa e qasjes në tregje; - Mos funksionimi i pikave grumbulluese për prodhimet bujqësore; - Kontaminimi i tokave bujqësore nga ujërat e zeza të pa kontrolluar; - Prerja e pyjeve në mënyrë të pakontrolluar; - Menaxhim i pamjaftueshëm i tokës; - Mungesë e qasjes në tregjet më të mëdha; - Mungesa e përpunimit të drurit dhe plasimit të produkteve të tij në treg; - Ndërprerjet e rrymës elektrike; - Akomodimi është i pamjaftueshëm me kapacitetet që i ofron Komuna e Deçanit dhe është e nevojshme të rritet standardi i shërbimit,

Mundësitë	Rreziqet
• Pozita gjeografike si zonë kufitare dhe urë lidhëse ndër-regjionale; • Projekte në investimin e turizmit/agro-turizmit dhe eko-turizmit; • Zhvillimi i fermave të vogla urbane organike; • Aplikimi i teknologjive të reja në bujqësi; • Inkurajimin e kultivuesve vendas nëpërmjet granteve të nivelit lokal dhe qendror për prodhimet bujqësore; • Stimulimi dhe mbështetja e zhvillimit të bletarisë dhe blegtorisë; • Bashkëpunim ndër-komunal për vendosjen e produkteve në tregun e tyre; • Hapja e tregjeve të reja; • Grumbullimi i frutave të malit dhe përpunimi i tyre -gështenja, boronica dhe çaji ; • Mundësi të mira për zhvillimin e produkteve vendore; • Mundësi për menaxhim më të mirë të pylltarisë; • Krijimi i hapësirave me destinimin për kultivimin e bimëve mjekësore; • Mundësi për burime të reja të energjisë solare. • Mbështetja e festivaleve të reja me qëllim që të promovoni qytetin, kulturën, traditën dhe argëtimin. • Promovimi i imazhit të ri dhe ofertës turistike të Deçanit, • Mundësi për burime të reja të energjisë solare. • Promovimi i imazhit të ri dhe ofertës turistike të Deçanit, • Investimet përmes partneritetit publiko-privat; • Zhvillimi i ofertës turistike dhe promovimi në nivel regional/ndërkombëtar; • Rehabilitimi i kanaleve të ujitjes në zonat rurale; • Edukimi i brezave të rinjë në Agro-turizem;	• Migrimi i brendshëm dhe i jashtëm i rinisë; • Mungesa e investimeve të nevojshme; • Ndotja e tokës bujqësore dhe burimeve ujore nga faktori natyror dhe faktori njeri, • Shëndrrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore; • Kredi të papërshtatshme dhe të paqëndrueshme nga bankat; • Dëmtimi i pyjeve nga faktorët njeri dhe natyrorë (prerja e pakontrolluar); • Dëmtimi i gështenjes dhe frutave të malit dhe arres nga sëmundjet e ndryshme ; • Katastrofat natyrore si erërat e forta, stuhitë, breshri dhe vërshimet i cenojnë rendimentet bujqësore; • Rritje e ndotjes së ambientit; • Dëmtimi i shtratit të lumenjve ; • Shfrytëzim i pakontrolluar i resurseve natyrore ; • Buxheti i vogël i komunës. • Konkurrenca e prodhimeve nga importi në mungesë të politikave qendrore për mbrojtjen dhe zhvillimin e prodhimeve vendore; • Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; • Braktisja e fshatrave, interesimi i ulët i rinisë për veprimtari bujqësore; • Kontaminimi i bunarëve nga ujërat e ndotura; • Problemet me ujëra të ndotura që dëmtojnë edhe kulturat bujqësore; • Prerja ilegale e pyjeve (e pa kontrolluar);

PJESA 4

OBJEKTIVAT DHE SYNIMET STRATEGJIKE PËR ZHVILLIMIN RURAL 2024-2029

Strategjia për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028⁸, pasqyron nevojën për zhvillimin e sektorit të bujqësisë dhe zonave rurale, për të konkuruar në tregjet e Bashkimit Evropian dhe tregje rajonale përmes masave për rritjen e efikasitetit të prodhimit, përpunimit dhe marketingut bujqësor, dhe për të ndërtuar institucione të përshtatshme, efektive publike dhe private; për të përmirësuar të ardhurat e fermave; për të siguruar që konsumatorët të kenë qasje në ushqim të sigurt dhe të shëndetshëm, në mënyrë të qëndrueshme mjedisore; dhe për të ndërtuar komunitete rurale të qëndrueshme përmes zhvillimit të qëndrueshëm rural.

Sipas analizave të përmbledhura; analizës SWOT, analizës sektoriale janë përcaktuar objektivat strategjike dhe specifike, të cilat janë edhe në përputhshmëri me PBZHR 2022-2028.:

4.1. Objektivat Strategjike dhe specifike

Objektivi Strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës.

Objektivi specifik 1.1:

Mbështetja e të ardhurave të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore.

Objektivi specifik 1.2:

Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit të tregut duke përfshirë fokus më të madh në kërkimin, inovacionin, teknologjinë dhe digjitalizimin.

Objektivi specifik 1.3:

Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës: Ndërlidhja e tregut distributoreve përpunueseve dhe prodhueseve.

Objektivi Strategjik 2 : Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore.

Objektivi specifik 2.1:

Kontributi në zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme.

Objektivi specifik 2.2:

Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas te toka, uji dhe ajri.

Objektivi specifik 2.3:

Mbrojtja e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve.

⁸ Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural 2022

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i biznesit në Zonat rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale.

Objektivi specifik 3.1:

Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë.

Objektivi specifik 3.2:

Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve.

Objektivi specifik 3.3:

Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme: [*\(Shiko Shtojcën 1. Planin e veprimit dhe ndarja e projekteve sipas Objektivit Strategjik\)*](#).

Duhet të theksohet sërish se këto prioritetë duhet të shihen më shumë si të dhëna apo udhëzues bazuar në ekspertizën lokale sesa një plan i hollësishëm zbatimi sepse varet nga interesimi i Qeverisë qendrore, lokale dhe donatorë për investime.

4.2. Problemet kryesore të identifikuara në zonat rurale sipas SBZHR 2022-2028

Me një dendësi shumë të madhe të popullsisë (rreth 170 banorë/km²), rreth 57% e popullsisë së vendit (1.873 milion) jeton në zona rurale, krahasuar me mesataren e BE-së prej 15%. Zonat rurale varen kryesisht nga sektori parësor dhe kanë të ardhura për kokë banori që janë dukshëm më të ulëta se mesatarja e vendit (me një të tretën në rastin e vendeve të BE-së).⁹

Ekonomia rurale ka mundësinë të zhvillohet duke u mbështetur në burimet natyrore (të tilla si toka pjellore dhe pyje të gjera), peizazhe dhe tradita të bukura në përpunimin e ushqimit, që përputhen me një kërkesë në rritje për produktet tradicionale dhe turizmin rural.

Hapja e një biznesi është relativisht e lehtë në Kosovë, ndërsa bizneset e reja ende mund të mbështeten në disponueshmërinë e fuqisë punëtore. Kërkesa e fortë e tregut të jashtëm për bimët mjekësore dhe aromatike dhe për produktet pyjore jo drusore mundësoj zhvillimin e qendrave të grumbullimit dhe kanaleve të konsoliduara tregtare.

Ekziston një përvojë e mirë në nivelin qendror dhe lokal për përgatitjen dhe zbatimin e iniciativave të zhvillimit lokal (duke përfshirë përgatitjen e Strategjive të Zhvillimit Lokal) dhe një interes në rritje për këtë qasje. Megjithatë, zhvillimi ekonomik i zonave rurale mbetet shumë i dobët. Përqindja e lartë e bizneseve dhe fuqisë punëtore të pargjistruar, niveli i lartë i migrimit nga zonat rurale (veçanërisht të rinjve), mungesa e kapitalit financiar për investime, fuqia punëtore e kualifikuar e padisponueshme dhe infrastruktura e dobët rurale (duke përfshirë infrastrukturën sociale, si p.sh. kopshtet e fëmijëve) janë pengesa të rëndësishme në zhvillimin e ekonomisë rurale.

⁹ Strategjia për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (MBPZHR) 2022-2028

Menaxhimi i mbeturinave – kemi ngecje në riciklimin e mbeturinave, ndërsa hedhja ilegale e mbeturinave përgjatë rrugëve dhe rrjedhave të ujit është një praktikë e zakonshme.

Në nivel administrate, Agjencisë së Pagesave i mungojnë procedurat e përshtatura për të siguruar një funksionalitet me kohë të plotë të GLV-ve. Gjithashtu, GLV-të, nuk janë ende të fuqizuara, as teknikisht të gatshme për të nisur thirrje të hapura për përzgjedhjen e projekteve që duhet të përshtaten me prioritetet vendore. Shërbimet këshilluese ende nuk po i trajtojnë siç duhet çështjet e biznesit rural. OJQ-të lokale (për mbrojtjen e mjedisit, fuqizimin e grave, zhvillimin e qëndrueshëm etj.) janë një burim i vlefshëm që mund të përfshihet në mënyrë efikase në zhvillimin e zonave rurale.

Turizmi rural stimulon ekonominë lokale përmes rritjes së konsumit. Në mënyrë që shpenzimet turistike të mbeten në ekonominë lokale, është e rëndësishme që ushqimi të vijë nga zona aty pranë ose edhe më mirë, nga nikoqiri. Agro-turizmi është mënyra më e mirë për t'i shtuar vlerën prodhimit agro-ushqimor vendor. Ekziston nevoja për të inkurajuar fermat që të diversifikojnë aktivitetet e tyre drejt turizmit rural në shkallë të vogël.

Rrugët rurale, pyjore dhe bujqësore, sistemet e ujit dhe kanalizimit, energjia elektrike dhe menaxhimi i mbeturinave janë pjesë e infrastrukturës bazë të nevojshme për të mbajtur ekonominë lokale dhe për të siguruar kushte të mira jetësore. Kosova ka mungesë të lartë të të gjithave që u thanë më lart, duke shtuar infrastrukturën sociale (p.sh. kopshtet për fëmijë, objektet për ngjarje kulturore dhe sportive etj.).

Pavarësisht përvojës së mirë në qasjen LEADER, GLV-të, ende kanë nevojë për mbështetje për përgatitjen e Strategjive Zhvillimore Lokale dhe zbatimin e tyre. Për ndarjen e funksionit të menaxhimit nga funksioni i përzgjedhjes së projekteve, GLV-të duhet të trajnohen nga GLV-të, me përvojë nga shtetet anëtare të BE-së. Në të njëjtën kohë, stafi i Autoritetit Menaxhues dhe i Agjencisë së Pagesave duhet të trajnohen mbi sistemin e zbatimit që siguron një rrjedhje të vazhdueshme të parasë për kostot e funksionimit të GLV-ve.

Hedhja ilegale e mbeturinave është një fenomen i përhapur gjerësisht që duhet trajtuar. Fushatat e ndërgjegjësimit që stimulojnë ndjenjën e komunitetit dhe respektimit të mjedisit dhe kontrollet për aplikimin e gjobave për ata që shkelin rregullat janë veprime të nevojshme.

4.3. Vështirësitë kyçe që hasen në sektorin rural, përfshijnë:

- Infrastruktura rurale: rrugët e këqija, qasje e kufizuar në ujë dhe pijshëm dhe mënjanimi i dobët i mbeturinave, rrjeta telefonike, IT dhe rryma elektrike e kufizuar;
- Qasje e kufizuar në zonat malore: të pazhvilluara, qasje e dobët në infrastrukturë dhe kullosa në zonat më pak të favorizuara;
- Kreditë komerciale dhe mikrofinanciare nuk mund të përballohen financiarisht;
- Investimi vendor në prodhim dhe përpunimin bujqësor është i limituar;
- Probleme në kontrollin e kualiteti të ushqimit;
- Aplikimi i kufizuar i teknologjive të reja dhe shkathtësive moderne të punës
- Sistemi i ujitjes i varfër dhe i kufizuar në mbulim dhe teknologji;
- Përdorim jo adekuat i tokës dhe mos konsolidimi të saj;

- Numër i kufizuar i pikave për grumbullimi e artikujve me përdorim të gjerë, përfshirë këtu rolin e kooperativave dhe minifabrika për përpunimin e këtyre produkteve përfshirë dhe frutat e malit, erëzat dhe bimët mjekësore;
- Numër i kufizuar i shoqatave të prodhuesve dhe mungesa e organizimit të atyre ekzistuese;
- Përkrahje e kufizuar për çështjet gjinore dhe minoritare;
- Shërbimet rurale këshilluese të pamjaftueshme;
- Mos funksionimi dhe privatizimi i pa përfunduar i ndërmarrjeve shoqërore;

Kualitetet unike të rajonit do të shfrytëzohen që të ofrojnë turistëve një vend atraktiv për të kaluar kohën. Natyra e qetë e bjeshkëve të Deçanit në pjesën perëndimore është vend i mrekullueshëm për rekreacion siç është shëtitja.

Qyteti ka një atmosferë të këndshme dhe si i tillë ofron hapësirë, sipërfaqe të gjelbra, lumin dhe peizazhin unik të bjeshkëve. Ju ofron banorëve dhe vizitorëve një llojshmëri dyqanesh dhe restorantesh. Pjesa më e madhe e rajonit lindorë mbetet në shfrytëzim për bujqësi.

Megjithatë turizmi dhe bujqësia në veçanti nuk mund të krijojnë vende të mjaftueshme pune për të luftuar shkallën e lartë të papunësisë.

Duhet të zhvillohet një ekonomi e vogël private. Shfrytëzimi i lokacioneve strategjike në Deçan bën që hapësirat e përcaktuara të jenë atraktive për vendosjen e këtyre bizneseve. Pasi që kjo do të tërheqë popullatën kah qyteti do të ketë nevojë për krijimin e hapësirës banuese.

Sipërfaqe për aktivitete industriale dhe biznes do të jenë rezervuar në lokacionet e përshtatshme në pjesën lindore të qytetit përgjatë infrastrukturës kryesore.

Aktivitetet ekonomike krijojnë ambient ku do të ketë nevojë për fuqi punëtore të shkathët. Anasjelltas fuqia punëtore e shkathtë do të tërheqë ca biznese të veçanta.

PJESA 5

PANELI I EKSPERTËVE DHE SHPORTA E PROJEKTEVE

5. PANELI I EKSPERTËVE LOKAL/GRUPET TEMATIKE

Siç është sqaruar më sipër, ky grup punues është themeluar në bazë të partneriteti publiko-privat duke përfshirë: përfaqësuesit e komunës, përfaqësuesit nga shoqëria civile dhe fermerë individual.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile ishin njerëz që përfaqësonin organizatë, OJQ, grupe të rinjëve, pasi secili prej tyre mund të konsiderohet si udhëheqës lokal dhe përgjegjës për anëtarët tjerë të organizatës së tij.

Prandaj, secili nga anëtarët e Panelit ka një përvojë të veçantë në të paktën një fushë dhe të gjithë ndajnë së bashku dëshirën për të punuar për zhvillimin e komunës së tyre.

Gjatë muajit Tetor 2024, gjatë punëtorive janë formuar 8 grupe tematike me ekspertë lokal për të mirën e zhvillimit rural në Komunën e Deçanit.

Nr.	Tema	Emri	Mbiemri	Spektori	Organizata	Pozita
1	Bujqësia - prodhimi	Bajram	Çeku	Privat	GLV Gjeravica	Kryetar
		Imer	Nitaj	Privat	DPT-Dinamanti	Menaxher i fidanishtes
		Haki	Tahirukaj	Privat	OJQ -Shoqata Bletarëve Deçanit	Kryetar
		Rifat	Stojkaj	Publik	Komuna Deçan	Drejtor i Drejtorisë BZHR
		Taf	Çeku	Privat	OJQ Blegtor	Kryetar
		Besim	Zekaj	Privat	Prodhues perimesh	Menaxher
		Bajram	Dervishaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtar për zhvillim rural
2	Bujqësia Infrastruktura	Riza	Kasumaj	Publik	Komuna Deçan	Drejtorja Urbanizmit
		Xhevat	Lufaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtar për planifikim zhvillimor
		Shkelzen	Shehu	Publik	Komuna Deçan	Zyrtar i Urbanizmit
		Blerta	Gjocaj	Publik	Komuna Deçan	Drejtorja Urbanizmit
3	Resurset tjera natyrore - turizmi	Mirsat	Nimanaj	Privat	Biznes Privat	Menaxher
		Isuf	Demhasaj	Publik	Komuna Deçan	Drejtor ne Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim
		Edona	Kameraaj	Publik	Komuna Deçan	Zëdhënëse e Komunës
		Ajne	Iberhysaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtare Mbr. Mjedisit
		Fehmi	Dervishaj	Privat	Restaurant Roshkodoli	Menaxher

		Artan	Ismajli	Publik	Shoqata e Gjuetarëve	Sekretar i shoqatës
4	Infrastruktura rurale dhe shërbimet në zonat rurale	Ajne	Iberhysaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtare mbr. Mjedisit
		Beqir	Berisha	Privat	Komuniteti Biznesit	Menaxher projekti
		Xhevat	Lufaj	Publik	Komuna Deçan	Shef për shërbime publike
		Ajshe	Qorraj	Publik	Komuna Deçan	Eksperte e Urbanizmit
		Xheladin	Malaj	Privat	GLV “Gjeravica”	Nënkryetar i GLV-së
		Kushtrim	Loshaj	Publik	NP “Higjiena”	Drejtor
		Hyse	Dinaj	Publik	Komuna Deçan	Specialiste e Ndërtimit
5	Mjedis dhe menaxhimi i tokës	Musë	Mushkolaj	Publik	Sektori Pylltari	Inspektor
		Jashar	Hulaj	Privat	Komuna Deçan	Ekspert i Bujqësisë
		Artan	Ismajli	Publik	Shoq. Gjuetarëve	Sekretar
		Ajne	Iberhysaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtare mbr. Mjedisit
		Hasan	Cacaj	Privat	SHPK -Hidroforca	Drejtor i kompanisë
		Egzon	Binakaj	Publik	Komuna Deçan	Financa
6	Menaxhimi i resurseve humane	Egzon	Binakaj	Publik	Komuna Deçan	Financa
		Maxhun	Shehaj	Privat	USAID	Zyrtar projekti
		Xhavit	Mulaj	Privat	OJQ “Fragaria”	Menaxher i organizatës
		Antigona	Dabiqaj	Publik	Komuna Deçan	Shërbime Publike
		Gentiana	Iberhysaj	Publik	Komuna Deçan	Shërbime Publike
7	Diversifikimi i të ardhurave të ekonomisë rurale	Mirsat	Nimanaj	Privat	Biznes Privat	Ekonomist
		Safete	Gacaferi	Privat	OJQ “Jeta”	Koordinatore
		Haki	Tahirukaj	Privat	OJQ Gështenja	Menaxher
		Xheladin	Malaj	Publik	Komuna Deçan	Shef i Urbanizmit
		Egzon	Binakaj	Publik	Komuna Deçan	Financa
		Bajram	Dervishaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtar për zhvillim rural
8	Çështjet rinore dhe gjinore	Safete	Gacaferi	Privat	OJQ “Jeta”	Koordinatore
		Ajne	Iberhysaj	Publik	Deçan	Zyrtare për DNJ bar.gjinore
		Fatmire	Zukaj	Publik	Komuna Deçan	Zyrtare
		Bekim	Vishaj	Publik	Komuna Deçan	Shef i Drejtoria Kulturës

		Edona	Kameraj	Publik	Komuna Deçan	Zyra Informimit
		Vlera	Balaj	Publik	Shkolla Kasumaj Tafil	Nxënëse

5.1. Identifikimi i nevojave për zhvillimin ekonomik rural

Identifikimi i zhvillimit rural lokal synon identifikimin e çfarëdo personi apo organizate me interes të veçantë, aftësi apo njohuri për çfarëdo çështje të lidhur me zhvillimin rural në komunë. Kjo do të ishte e dobishme për të ftuar personat lokal të bashkëngjiten në një grup pune apo të krijojnë grupet e synuara për transmetimin apo përhapjen e rezultateve dhe përvojave. Ky identifikim është qenësor për çfarëdo qasje të bazuar në zhvillimin e zonave rurale.

5.2. Shporta me projekte dhe ide lokale

Grupet tematike, kanë identifikuar një listë me projekt propozime dhe ide nga takimet e organizuara dhe punëtorit në kuadër të projektit.

Shporta me projekte, në këtë fazë, përbëhet nga një listë me ide të strukturuar, që ende plotësisht nuk mund të kompletohen dhe formësohen për të qenë me përshkrime të projekteve. Si plan strategjik këto asnjëherë nuk janë dokumente përfundimtare, shporta me projekte është gjithmonë e gatshme të plotësohet me ide të reja, derisa idetë tjera ngadalë do të zhduken me procesin e zbatimit/realizimit të tyre, (*[Shtojca 1 – Projektet e planifikuara dhe ndarja buxhetore 2024-2029](#)*).

5.3. Strategjia zhvillimore lokale në përputhje me Programin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022 -2027

Gjatë hartimit të SZHL, jemi fokusuar që çdo herë ta kemi një koherencë në mes kësaj Strategjie dhe PBZHR-2022-2027. Programi është i bazuar në Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, Ligjin Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, Ligjin Nr. 04/L-090 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-098 për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural. Departamenti i Politikave të Zhvillimit Rural/Autoriteti Menaxhues (AM) ka përgatitur Programin e Zhvillimit Rural 2022, i cili është i bazuar në analizën e pavarur sektoriale për sektorët kryesor të bujqësisë dhe zhvillimit rural, të financuar nga zyra e BE në Kosovë.

Kjo masë është e lidhur me Masën 9 - “Asistenca Teknike”. Asistenca Teknike mbështetë GLV-të, e mundshme që të jenë të gatshme të aplikojnë për masën "Qasja LEADER". Gjithashtu edhe Rrjetëzimi i GLV-ve, mbështetet nga masa e Asistencës Teknike të IPARD.

Objektivat specifike dhe lidhshmëria me PBZHR 2022-27

- Përmirësimi i kapitalit social dhe qeverisjes vendore duke krijuar një partneritet publiko – privat, i cili krijon dhe zbaton strategjitë e zhvillimit lokal;
- Animimi i territorit dhe ngritja e kapaciteteve të popullatës lokale dhe Grupeve Lokale të Veprimit;
- Kontributi në ekonominë rurale, turizmin rural, forcimin e jetës kulturore dhe sociale të komunitetit, përmirësimi i zonave publike në zonat rurale, përmirësimi i standardeve mjedisore në zonat e GLV-ve si temat kryesore për strategjitë e zhvillimit lokal;
- Rrjetëzimi me GLV-të e tjera, shkëmbimi i praktikave më të mira, shpërndarja e programeve IPARD dhe mësimi i qasjeve të reja për zhvillimin rural në nivel kombëtar, si me vendet kandidate ashtu edhe me shtetet anëtare;
- Funkcionalizimi i GLV-ve, të përzgjedhura sipas “Qasjes LEADER”;
- Ndërtimi i kapaciteteve të GLV-ve, të përzgjedhura dhe RRZhR-së.

Ndër prioritetet kryesore janë:

- Ekonomia rurale: zhvillimi i zinxhirëve të shkurtër të furnizimit dhe produkteve me vlerë të shtuar, duke përfshirë produkte cilësore, zeje dhe aktivitete të tjera për të diversifikuar ekonominë rurale;
- Turizmi rural: zhvillimi i produkteve të turizmit rural bazuar në përdorimin e burimeve lokale, natyrore dhe kulturore;
- Komuniteti: inkurajimi i jetës kulturore dhe sociale të komunitetit dhe mbështetja e organizatave kolektive lokale, shoqatave dhe organizatave joqeveritare;
- Hapësirat publike: përmirësimi i hapësirës publike në fshatra;
- Mjedisi: përmirësimi i standardeve mjedisore në zonat e GLV-ve, dhe promovimi i përdorimit të energjisë së rinovueshme nga komuniteti lokal;
- Rrjetëzimi: rrjetëzimi i GLV-ve, shkëmbimi i praktikave më të mira, shpërndarja e programeve IPARD dhe mësimi i qasjeve të reja për zhvillimin rural.
- Zbatimi i Strategjisë së Zhvillimit Lokal përfshin: aktivitetet e animimit dhe ngritjes së kapaciteteve, projektet e vogla dhe kostot rrjedhëse për GLV-në. Aktivitetet duhet të lidhen me temat prioritare të përzgjedhura më sipër.

5.4. Strategjia Zhvillimore Lokale në pajtim me Strategjinë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028

Strategjia Kombëtare për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për periudhën 2022-2028, pasqyron prioritetet e vendit për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale, si dhe ofron mbështetje për sektorin e bujqësisë për të arritur një nivel të mjaftueshëm konkurrueshmërie për të përballuar sfidat e tregut të hapur dhe të ndryshueshëm dhe gjithashtu për të nxitur zhvillimin e zonave rurale.

Objektivat strategjike dhe specifike të Strategjisë për Bujqësi dhe Zhvillim Rural 2022-2028, janë përcaktuar përmes një analize të problemeve dhe shkaktarëve të tyre.

- Objektivi strategjik 1: Rritja e konkurrueshmërisë së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës;
- Objektivi Strategjik 2: Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore;
- Objektivi Strategjik 3: Mbështetje për bizneset në zonat rurale, rritjen e punësimit dhe përmirësimin e infrastrukturës sociale;
- Objektivi Strategjik 4: Reforma gjithëpërfshirëse institucionale dhe sektoriale për të krijuar shërbime publike efikase;

Sa më e madhe që është ferma, aq më të larta janë të ardhurat për numër punëtorësh. Bujqësia e Kosovës karakterizohet nga bujqësia e shkallës së vogël. Pothuajse 70% e fermave me tokë të punueshme janë deri në 2 ha, dhe më shumë se 60% e tokës së punueshme është në pronësi të fermave me sipërfaqe deri në 5 ha.

Në pjesën më të madhe, bujqësia mbetet kryesisht si veprimtari tradicionale që mbijeton në mungesë të burimeve tjera të të ardhurave dhe pa mjetet e duhura për modernizim.

Pavarësisht nga rritja relative e fuqishme blerëse në nivel kombëtar gjatë viteve 2017 - 2021, Kosova mbetet me vlerën më të ulët në ekuivalencë me fuqisë blerëse në rajon.

Komunat po vazhdojnë të lansojnë skema mbështetëse lokale për fermerët, të cilat nuk janë pjesë e politikës së ministrisë së linjës, as të strategjive të zhvillimit lokal, duke humbur kështu mundësinë për të siguruar koherencë në iniciativat lokale. GLV-të, ekzistuese nuk janë ende gati për marrjen e përgjegjësisë më të larta në përzgjedhjen e projekteve lokale sipas prioriteteve lokale pa trajnime të mëtejshme, të marra nga persona me përvojë/GLV-të, e tjera nga vendet e BE-së.

PJESA 6
ZBATIMI I STRATEGJISË ZHVILLIMORE LOKALE -
QASJA LEADER DHE REKOMANDIMET

6. ZBATIMI I STRATEGJISË ZHVILLIMORE LOKALE 2024-2029

6.1. Monitorimi dhe Vlerësimi

Organi përgjegjës për zbatimin e strategjisë zhvillimore lokale në komunë do të jetë grupi lokal i veprimit (GLV). Bordi i GLV-së, formojnë së bashku një Këshill monitorues i cili do të jetë përgjegjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë zhvillimore rurale 2024-2029, dhe hartimin e rekomandimeve për veprimet në vijim.

Ekipa e ekspertëve, të përcaktuar sipas kategorive në panelin e ekspertëve, do të monitoroj të gjitha projektet në zbatim në kuadër të strategjisë dhe do t'i vlerësojë ato pas përfundimit, në veçanti:

- Ekipi i ekspertëve, do të monitoroj të gjitha projektet në zbatim në kuadër të strategjisë dhe do t'i vlerësojë ato pas përfundimit.
- Ekipi i ekspertëve, do të ftohet nga Bordi i GLV-së në çdo gjashtë mujor, gjithsejtë 2 herë në vit;
- Ekipi i ekspertëve, do të kërkoj raportet e zbatimit nga të gjithë përfituesit e projekteve që tanimë zbatojnë projektet;
- Të gjithë përfitues zbatues do t'i dorëzojnë raportet e tyre të rishikuara Bordit deri në fund të vitit kalendarik;
- Bordi do të zhvillojë një raport rreth përparimit të projekteve të miratuara dhe gjendjes së tanishme të zbatimit të planit;
- Projektet e përfunduara do të jenë subjekt i vlerësimit individual;
- Raporti do të përfshijë rekomandimet për veprimet e ardhshme drejt zbatimit të suksesshëm të planit dhe rishikimit të sugjeruar, nëse është nevoja, përfshirë propozimet për projektet e reja;
- Përfundimet dhe rekomandimet e Bordit do të dorëzohen në kuvendin vjetor të GLV-së për shqyrtim dhe vendimmarrje.

6.2. Informimi i publikut

Dokumenti i pranuar i strategjisë zhvillimore lokale duhet t'i prezantohet publikut e në veçanti banorëve rural. Pasi ata zakonisht kanë qasje të kufizuar në informatat publike rekomandohet që dokumenti të paraqitet në tabelën lokale informative në nivel të fshatrave apo në mënyrë tjetër të shpërndarjes e informatave lokale (p.sh. thirrja e mbledhjeve në fshat).

Në mënyrë që dokumenti të jetë i lexueshëm dhe kuptueshëm nga njerëzit rural, dokumenti duhet të prezantohet në një material shumë konciz që përfshinë gjërat kryesore si vizionin dhe synimet, temat kryesore dhe një listë me projektet me ballinë me emrin e autorit (pronarit të strategjisë), titullin, intervalin kohor dhe zonën e referimit.

Veç kësaj, GLV-ja duhet të publikoj, në baza vjetore, informatat vjetore në mediat lokale lidhur me arritjet; të prezantojë raportin e përparimit, përfshirë rishikimin e planeve

vjetore, gjatë takimeve vjetore të GLV-së; të informojë dhe freskojë zyrtarin komunal të planifikimit lidhur me tërë përparimin që është bërë lidhur me zbatimin e projektit.

6.3. Legjitimiteti i Strategjisë

Mënyra më e mirë e miratimit të strategjisë është pranimi i dokumentit nga pronari (GLV-ja) dhe pastaj të pranohet nga pushteti lokal përgjegjës për zhvillimin rural. Kjo procedurë angazhon të gjithë akterët lokal të rëndësishëm për të planifikuar dhe ndihmuar zbatimin e projektit të përshkruar në strategji.

Është me rëndësi që teksti i dokumentit të strategjisë 2024-2029, të miratohet nga kuvendi i përgjithshëm i grupit lokal të veprimit. Të gjithë kapitujt e dokumentit dhe komponentët e tij thelbësor (p.sh. deklarata e misionit, synimet strategjike dhe struktura e zbatimit) fillimisht janë diskutuar dhe dakorduar nga grupet tematike dhe organet ekzekutive të GLV-së gjatë rrjedhjes së zhvillimit të strategjisë. Prandaj përkushtimi i GLV-së ndaj planit dhe zbatimit duhet të shprehet qartë nga të gjithë anëtarët e GLV-së.

Veprime dhe vendime të tilla të marra nga pronari i strategjisë dhe autoritetit komunal, do të fuqizojë çfarëdo aktiviteti të mëtutjeshëm të ndërmarr në kornizën e strategjisë zhvillimore rurale.

6.4. Projektet

Projekt propozimet janë zhvilluar në bazë të punës së grupeve tematike të GLV-së, dhe hulumtimeve analitike të bëra nga anëtarët e GLV-së. Rezultatet përqafojnë disa prioritetë të përcaktuara si shtylla drejtuese për veprimet e mëtutjeshme (matrica e zhvillimit rural). Grupet tematike kanë përmbledhur rezultatet e punës së tyre në disa projekte të cilat ata mendojnë se duhet zbatuar për të ndihmuar zhvillimin e viseve rurale të komunës.

Lista e projekteve paraqet informatat thelbësore dhe koncize që i drejtohen temave përgjegjëse, titullit, vlerës në tërësi, prioritetëve, kohës, pronësisë dhe rezultateve të pritura. Lista po ashtu përfshinë projektet të cilat tanimë janë identifikuar në komunë por nuk janë zbatuar për shkak të mungesës apo mjeteve të pakta financiare.

Është me rëndësi të thuhet se lista është fleksibile dhe e hapur për çfarëdo ide dhe propozime të reja të cilat plotësojnë synimet e strategjisë. Varet nga GLV-ja, nëse vendosë të përfshijë propozimet e reja në listë gjatë procesit të freskimit të dokumentit.

6.5. Rishikimi i strategjisë zhvillimore lokale -Qasja Leader

Strategjia Zhvillimore Lokale, do të rishikohet dhe përshtatet me situatën dinamike çdo tri vite pas miratimit. Bordi i GLV-së, do të organizojë procesin e rishikimit dhe konsultimin me zyrtarët komunalë dhe akterët tjerë me interes të veçantë në zhvillim rural.

Të gjitha ndryshimet e miratuara do të jenë subjekt i pranimi nga Kuvendi i Përgjithshëm i GLV-së. Varësisht nga thirrjet për projekte nga MBPZHR dhe IPARD dhe donatorë tjerë.

6.6. Supozimet dhe Rreziqet

Supozimet dhe rreziqet potenciale janë identifikuar gjatë procesit të analizës SWOT, si dhe rezultatit të gjyimit të faktorëve tjerë që mund të ndikojnë në procesin e zbatimit të planit. Në veçanti:

- Udhëheqësit lokal pasiv;
- Mungesa e promovuesve për të iniciuar projektet zhvillimore;
- Mungesa e mjeteve financiare për financim.

Secila nga çështjet e sipërpërmendura seriozisht mund të pengojë zbatimin e Strategjisë Zhvillimore Lokale.

7. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Përfundimet dhe rekomandimet më poshtë janë bazuar në konkludimet dhe rezultatet e vizitave në teren dhe takimeve të ndryshme të organizuara në kuadër të projektit, me grupet tematike dhe përfaqësuesit Institucional dhe shoqërisë civile në komunën e Deçanit, dhe në diskutimet me anëtarët e GLV-së.

Kjo Strategji, është përgatitur duke u bazuar në përvojën, resurset, përparësitë, mundësitë, dobësitë dhe rreziqet lokale.

Megjithatë, në vazhdimësi janë paraqitur çështje lidhur me financimin dhe qëndrueshmërinë. Po ashtu ka interesim të shtuar nga administrata komunale për gjetjen e fondeve nga buxheti komunal për mbështetje të projekteve të vogla për realizim nga GLV-ja.

Ne kemi përkushtimin në nivelin lokal dhe komunal dhe të gjithë anëtarët e GLV-së, të cilët janë duke punuar vetëm në baza vullnetare. Niveli qendror duhet edhe më tutje të përkrahë nismën nëse dëshiron që viset rurale në Kosovë të arrijnë “konkurrencën territoriale”.

Brenda qasjes LEADER, një zonë bëhet konkurruese nëse mund t’i bëjë ballë konkurrencës së tregut derisa në të njëjtën kohë siguron qëndrueshmëri mjedisore, shoqërore dhe kulturore, bazuar në qasjen e dyfishtë të rrjetëzimit dhe marrëdhënieve ndër-territoriale. Kjo është në përputhje të përkryer me vizionin për të ardhmen e Komunës së Deçanit, të përcaktuar nga GLV-ja.

Përfundimi dhe rekomandimi ynë për anëtarët e GLV-së, dhe Komunën e Deçanit, është që të adaptojnë qasjen LEADER+ si një rrymë udhëheqëse për zhvillimin rural, duke:

- ✦ Marr parasysh resurset e zonës për çfarëdo projekti zhvillimor lokal;
- ✦ Përfshirë akterë të ndryshëm dhe institucione në nivelin lokal dhe kombëtar;
- ✦ Integruar sektorët e biznesit në një dinamikë inovative;
- ✦ Bashkëpunuar me viset tjera dhe duke u lidhur me politikat rajonale, kombëtare dhe Evropiane si dhe në kontekstin global.

Prandaj qëllimi ynë është që të zbatojmë një strategji zhvillimore lokale, e cila akterëve dhe institucioneve lokale u siguron përmirësimin e aftësive për të vlerësuar mjedisin e tyre, që të marrin veprime të përbashkëta, të krijojnë lidhje midis sektorëve duke siguruar shtimin e maksimal të vlerës, dhe së fundi të lidhet me viset tjera në rajon dhe me tërë botën.

Anëtarët e GLV-së, dhe Institucionet komunale, duhet të pranojnë se procesi i hartimit të strategjive zhvillimore lokale është vetëm një pikënisje. Rruga tutje është e gjatë por rezultatet e pritura për tërë bashkësinë mund të jenë shumë shpërblyese.

Pas aprovimit të Strategjisë Zhvillimore Lokale 2024-2029, nga zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, do të vazhdohet me kujdes në zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Niveli qendror duhet të përkrahë funksionin e GLV-ve, në mënyrë që të jenë të qëndrueshme dhe me një “konkurrencë territoriale”.

GLV “Gjeravica”, do të përkushtohet në realizimin e projekteve për zhvillimin rural sipas qasjes LEADER të BE-së, dhe Strategjisë së Zhvillimit Lokal 2024-2029, duke përcaktuar si zonë veprimi Komunën e Deçanit si më poshtë:

- ✦ Të realizojë aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të akterëve lokal të cilat bëjnë të mundur forcimin e partneritetit rural sipas qasjes së vetëveprimit të komunitetit nga poshtë-lart;
- ✦ Të shërbejë si model fillestar për të garantuar pjesëmarrjen dhe financimin e mëtejshëm të tij përmes konkurrimit të hapur në fondet e programeve të BE-së.
- ✦ Të botoj përmbledhje praktike dhe guida që lidhen me veprimtarinë e GLV “Gjeravica”, dhe modelet e saj në vende të ndryshme të BE-së;
- ✦ Të krijojë lidhje për bashkëpunim me organizata homologe të llojit GLV-ve, në vende të ndryshme të Rajonit dhe në Evropë;
- ✦ Të organizojë fushata ndërgjegjësuere për rritjen e pjesëmarrjes së grupeve të ndryshme në procesin e vendimmarrjes politike për zhvillimin rural ;
- ✦ Të nxisë më tej aktivitetet që lidhen me zhvillimin rural duke përkrahur, mbështetur dhe bashkë financuar investime përmes partneritetit publik-privat.
- ✦ Të bëjë të njohur përmes botimit të fletëpalosjeve, gazetave, web, apo faqeve në internet aktivitetet e ndryshme të GLV “Gjeravica” ;
- ✦ Të organizojë aktivitete si konferenca, seminare, punëtori, trajnime lidhur me zhvillimin e qëndrueshëm rural sipas prioriteteve të zhvillimit që përcakton Strategjia e Zhvillimit Rural 2024-2029.

Komuna e Deçanit ka potencial për zhvillim e turizmit dhe bujqësisë për shkak të pozitës gjeografike dhe plleshmërisë së lartë të tokës dhe sasisë së bollëshme të ujrave dhe kullotave. Hapja e një dege të Bujqësisë dhe Pylltarisë, në SHMT “Tafil Kasumaj” dhe formimi i kooperativave bujqësore do të ndihmon në ngritjen e kapaciteteve për zhvillim të mëtutjeshëm.

Shtojca 1 . Plani i veprimit sipas objektivave dhe ndarja financiare 2024-2029, për SZHL 2024-2029

Objektivi Strategjik 1: Rritja e konkurrencës së sektorit agro-ushqimor dhe përmirësimi i efikasitetit dhe qëndrueshmërisë së prodhimit të fermës						
Objektivi specifik 1.1: Mbështetja e të ardhurave të qëndrueshme të fermës dhe elasticiteti për të rritur sigurinë ushqimore						
Aktiviteti	2025	2026	2027	2028	2029	Shuma Totale €
Investim në shtalla moderne në zonat rurale në Komunën e Deçanit		100,000		100,000		200,000.00
Investimi ne ferma ne hortikulture		25,000.00	25,000.00			50,000.00
Furnizim me mekanizëm bujqësor modern për kultivimin e kult. bujqësore	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00	20,000.00	100,000.00
Pikë grumbulluese –frigorifer për ruajtjen e prodhimeve bujqësore		40,000.00				40,000.00
Shuma Objektivi 1.1	20,000.00	185,000.00	45,000.00	120,000.00	20,000.00	390,000.00
Objektivi specifik 1.2: Rritja e konkurrencës dhe përmirësimi i orientimit të tregut duke përfshirë fokus më të madh në kërkimin, inovacionin, teknologjinë dhe digjitalizimin						
Investimet inovative ne serrat moderne - ndriçimi, ngrohja, ujitja - sistemi pikë-pikë	30,000.00	40,000.00		30000		100,000.00
Shuma Objektivi 1.2	30,000.00	40,000.00	0.00	30,000.00	0.00	100,000.00

Objektivi specifik 1.3: Përmirësimi i pozitës së fermerëve në zinxhirin e vlerës						
Brendimi i mjaltës së Deçanit		10,000.00				10,000.00
Përkrahja e bletarisë organike në zonat rurale	5,000.00		10,000.00			15,000.00
Ndërtimi i një pike grumbulluese të qumështit në fshatin Irzniq, për grumbullim të qumështit për fshatrat për rreth		30,000.00				30,000.00
Ngritja e kapaciteteve të fermave bujqësore	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	25,000.00
Shkëmbimi i eksperiencave me vendet e rajonit (fermerët LIDER)		4,000.00	4,000.00	4,000.00	4,000.00	16,000.00
Shuma Objektivi 1.3	10,000.00	49,000.00	19,000.00	9,000.00	9,000.00	96,000.00
Shuma totale OS 1	60,000.00	274,000.00	64,000.00	159,000.00	29,000.00	586,000.00

Objektivi Strategjik 2 : Menaxhimi i qëndrueshëm i resurseve natyrore						
Objektivi specifik 2.1: Kontributi në zbutjen dhe përshtatjen e ndryshimeve klimatike, si dhe energjinë e ripërtëritshme:						
Aktiviteti	2024	2025	2026	2027	2028	Shuma Totale €
Furnizimi me panela solar i stanit të gjuetarëve dhe renovimi i tij në bjeshkën e Baballoqit me kapacitet 1.5-2 kW	10,000.00	10,000.00	10,000.00			30,000.00
Vendosja e paneleve solare në shkollën fillore “Heronjët e Dukagjinit”			25,000.00			25,000.00
Furnizim me panele solare për bizneset prodhuese në Deçan, me kapacitet 1.5-2 kW	10,000.00		10000		10000	30,000.00
Përdorimi i biomasës së zonës së bjeshkëve të Deçanit për ngrohtore		30000		30000		60,000.00
Shuma Objektivi 2.1	20,000.00	40,000.00	45,000.00	30,000.00	10,000.00	145,000.00

Objektivi specifik 2.2: Nxitja e menaxhimit të qëndrueshëm dhe efikas te toka, uji dhe ajri:						
Ndërtimi i kanalit të ujitjes -Kanali i përroit në fshatin Glllogjan L= 600m dhe ndërtimi i kanalit të Mullirit në fshatin Glllogjan L=680m. Ndërtimi i kanalit të ujitjes në lagjen Sejfiqaj L=200m		45,000.00	78,500.00		12,000.00	135,500.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes në Kogjihoc nga grazhdi në drejtim të parcellave Stanica deri tek parcellat e Malajve - fshati Glllogjan L=400m	24,000.00					24,000.00
Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Baballoq, L=1500m				74,500.00		74,500.00
Ndërtimi i kanalit të ujitjes - Kanali i Prejlepit, Rastavicë nga shkolla deri tek ambulanta L=1300m		40,000.00	40,500.00			80,500.00
Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatin Dashinoc L=1600m		50,000.00	62,000.00			112,000.00
Ndërtimi i kanalit të ujitjes në fshatin Prapaqan L=1400 m	30,000.00		54,000.00			84,000.00
Vazhdimi I kanalit të ujitjes tek vija e gështenjes Strelc i Ulët L=1000m		60,000.00				60,000.00
Ndërtimi i digës për ujitjen e tokave bujqësore në periferi të Deçanit nga bjeshka			70,000.00			70,000.00

Ndërtimi i kanalit të ujitjes në lagjen Hadergjonaj në fshatin Pobergjë L=500m. Ndërtimi i kanalit të ujitjes nga lagja Lokaj deri tek Beqir Vokshi L=600m		30,000.00		36,000.00		66,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes në lagjen Osaj L=350m dhe Ndërtimi i kanalit tek topillat L=300m			28,000.00		8,000.00	36,000.00
Ndërtimi i pendës për ujitjen e tokave në fshatin Hulaj		80,000.00				80,000.00
Ndërtimi i pendës në rrepishtat e Prejlepi për ujitjen e tokave në fshatin Glllogjan	15,000.00					15,000.00
Pastrimi i kanalit kryesor nga masa vegetative nga fshati Llukë deri në fshatin Lumbardhë L=2500m	10,000.00					10,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes në fshatin Pozhar L=1450m		40,000.00		47,000.00		87,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes -kanali i Milekut në fshatin Irzniq L=700m			42,000.00			42,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes tek Jagozi në fshatin Gramaqel L=2500m dhe ndërtimi i kanalit të ujitjes në lagjen Beqaj deri tek lagja Dobraj L=2000m		70,000.00	70,000.00	75,000.00	100,000.00	315,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes në Kodrali deri tek kroi i Burecit L=100m dhe rregullimi i burimit tek kroi i Burecit	16,000.00	10,000.00				26,000.00
Ndërtimi i kanali të ujitjes -urë lidhëse tek vija e Gështenjës L=10m, Ndërtimi i kanali të ujitjes në fshatin Lebushë pjesa e epërme e fshatit-burimi i lartë ndër shkollë L=900m dhe ndërtimi i pikës akumuluese në fshatin Lebushë		20,000.00		54,000.00	20,000.00	94,000.00

Pastrimi i kanaleve të ujitjes në qytetin e Deçanit	20,000.00					20,000.00
Rregullimi i burimit të ujit tek kroi i fshati nk Dashinoc	7,000.00					7,000.00
Rregullimi i rrugëve fushore me zhavor në fshatin Dashinoc L= 400m	10,000.00					10,000.00
Rregullimi i rrugëve fushore me zhavor në fshatin Bababllaq L= 500m	15,000.00					15,000.00
Zgjerimi i rrugës fushore Bolloboshince dhe shtruarja me zhavor L=600m			15,000.00			15,000.00
Rregullimi i trotuarit tek shkolla e Prapaqanit deri Dubovik L=1000m				36,000.00		36,000.00
Hapja e rrugës dhe shtrimi me zhavor nga Gjamia e Pozharit deri tek Lluka e Epërme L=1000m					25,000.00	25,000.00
Funksionalizimi i rrugës fushore në lagjen Shala në Irzniq L=2000m			25,000.00	25,000.00		50,000.00
Shuma Objektivi 2.2	147,000.00	445,000.00	525,000.00	347,500.00	165,000.00	1,629,500.00

Objektivi specifik 2.3: Mbrojtja e biodiversitetit, shërbimet e zgjeruara të ekosistemit dhe ruajtja e habitateve dhe peizazheve:						
Identifikimi i trungjeve të vjetra në pyjet e Deçanit me vjetërsi mbi 200 vjeçare	5,000.00		6,000.00		6,000.00	17,000.00
Identifikimi i vatrave të Infeksionit të haloreve nga Insektet		5,000.00		5,000.00		10,000.00
Organizimi i trajnimeve profesionale për ruajtjen e pyjeve dhe regjenerimin e tyre	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00	5,000.00

Ndërtimi i hapësirave të gjelbërta në zonat rurale të Komunes së Deçanit		10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	40,000.00
Mbjellja e drunjeve dekorativ në parkun e shkollës në fshatin Irzniq		10,000.00	10,000.00			20,000.00
Rrethimi dhe rehabilitimi i varrezave në fshatin Carrabreg i ulet L=400m	10,000.00		18,000.00			28,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Llukë L=500m		20,000.00				20,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Llukë L=500m	10,000.00					10,000.00
Pastrimi dhe largimi i mbeturinave të Verrat e Llukës	10,000.00	10,000.00				20,000.00
Ndërtimi i ures tek tyrbja në fshatin Baballoq				50,000.00		50,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Drenoc L=650m	20,000.00	20,000.00				40,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Pobergj L=500m				15,000.00	15,000.00	30,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Irzniq L=500m			30,000.00			30,000.00
Rrethimi i varrezave në fshatin Pozhar L=400m	10,000.00	15,000.00				25,000.00
Rregullimi i ambientit të jashtëm në SHT Tafil Kasumaj dhe pajisje e kabineteve	10,000.00				20,000.00	30,000.00
Shuma Objektivi 2.3	76,000.00	91,000.00	75,000.00	81,000.00	52,000.00	375,000.00
Shuma totale OS 2	243,000.00	576,000.00	645,000.00	458,500.00	227,000.00	2,149,500.00

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i biznesit në Zonat rurale dhe rritja e punësimit dhe infrastrukturës sociale						
Objektivi specifik 3.1: Promovimi i punësimit, rritjes, përfshirjes sociale dhe zhvillimit lokal në zonat rurale, përfshirë bio-ekonominë dhe zhvillimi i qëndrueshëm i pylltarisë						
Aktiviteti	2024	2025	2026	2027	2028	Shuma Totale €
Hulumtimi i sipërfaqeve të virgjera për mbjelljen e sipërfaqeve të reja me Geshtenje		5,000.00		5,000.00		10,000.00
Ngritja e kapaciteteve të rinjve në aspektin turistik dhe bujqësor	3,000.00	5,000.00	4,000.00	3,500.00	2,500.00	18,000.00
Përpunimi i prodhimeve bujqësore në ekonomi familjare qumësht, djathë, mish	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Mbjellja e sipërfaqeve të reja me Gështenjë rezistente ndaj semundjeve	10,000.00		20,000.00	20,000.00	20,000.00	70,000.00
Sensibilizimi i popullatës “trajnimet” për zhvillimin e turizmit rural	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	25,000.00
Hapja e shtegut shumë të vjetër /Shtegu i Qelisë/ si zone atraktive turistike	20,000.00					20,000.00
Zhvillimi i turizmit kulturor dhe Agro-turizmit	2,500.00	2,500.00	3,000.00	3,000.00	2,500.00	13,500.00
Shuma Objektivi 3.1	50,500.00	27,500.00	42,000.00	46,500.00	40,000.00	206,500.00

Objektivi specifik 3.2: Përmirësimi i kërkesave shoqërore për ushqimin dhe shëndetin, përfshirë ushqimin e sigurt, ushqyes dhe të qëndrueshëm, zvogëlimin e mbeturinave të ushqimit, si dhe mirëqenien e kafshëve:						
Financimi i organizimit Ditët e Bletarisë në Komunën e Deçanit	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Përkrahje e grave në grumbullimin dhe përpunimin e produkteve malore në zonat rurale	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Trajnimi i Bletareve nga ekspert të jashtëm	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	35,000.00
Oranazimi i ditës Botërore të Bletarisë 20 Maji të Mbahet edhe në Deçan si traditë çdo vjet në komunën e Deçanit	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Organizimi i ditës së Geshtenjes	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Organizim i tradicional i qethjes së deleve	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Organizimi i darkës së lamës -tradicionale	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	10,000.00	50,000.00
Festimi i ditës së boronices në Komunën e Deçanit	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	35,000.00
Krijimi i mundësive për shitjen e produkteve bujqësore në një pikë të caktuar në zonën urbane	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	7,000.00	35,000.00
Shuma Objektivi 3.2	81,000.00	81,000.00	81,000.00	81,000.00	81,000.00	405,000.00

Objektivi specifik 3.3: Promovimi i barazisë gjinore, duke përfshirë pjesëmarrjen e grave në bujqësi dhe përfshirjen sociale të komuniteteve dhe grupeve të cënueshme						
Renovimi i fushes sportive te Oda e burrave ne fshatin Carrabreg i Eperm	10,000.00					10,000.00
Promovimi i produkteve bletare dhe perimore dhe artizanate ne panaiet ne Komunën e Deçanit	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	5,000.00	25,000.00
Identifikimi /shenjëzimi i pikave turistike dhe agro-turizmit në bjeshkët e Deçanit	5,000.00					5,000.00
Fuqizimi i grave ne turizmin rural ne Komunën e Deçanit	5,000.00		5,000.00		5,000.00	15,000.00
Rregullimi i rrethosjes se fushes sportive dhe renovimi i fushes sportive per KFF Deçan	20,000.00		25,000.00			45,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne shkollën fillore Lidhja e Prizrenit Deçan	15,000.00					15,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne shkollën e rastavices		15,000.00				15,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne qendren e fshatit Baballoq			15000			15,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne fshatin Dashinoc				15,000.00		15,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne fshatin Lloqan	15,000.00					15,000.00
Ndërtimi i këndit te lojërave ne fshatin Maznik					15000	15,000.00
Ndërtimi i këndit të lojërave për fëmijë ne 6 shkolla te Deçanit /Drenoc, Llukë,Irznig,Kodrati, Prejlep, Isniq/	17,000.00	17,000.00	17,000.00	17,000.00	17,000.00	85,000.00
Shuma Objektivi 3.3	92,000.00	37,000.00	67,000.00	37,000.00	42,000.00	275,000.00
Shuma totale OS 3	223,500.00	145,500.00	190,000.00	164,500.00	163,000.00	886,500.00

*Përmbledhja e investimeve sipas objektivave Strategjike për realizimin e
Strategjisë së Zhvillimit Rural 2024-2029*

Investimet sipas objektivave strategjike	2025	2026	2027	2028	2029	Shuma Totale €
Objektiva strategjike 1	60,000.00	274,000.00	64,000.00	159,000.00	29,000.00	586,000.00
Objektiva strategjike 2	243,000.00	576,000.00	645,000.00	458,500.00	227,000.00	2,149,500.00
Objektiva strategjike 3	223,500.00	145,500.00	190,000.00	164,500.00	163,000.00	886,500.00
Kostoja Totale	526,500.00	995,500.00	899,000.00	782,000.00	419,000.00	3,622,000.00

Financuar nga:

Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Masa V

Botues

Grupi Lokal i Veprimit – Gjeravica

Deçan

E-mail: lag.gjeravica@yahoo.com

Fcb: Grupi Lokal i Veprimit “Gjeravica”

Për botuesin:

Bajram Çeku -Kryetar

Hartues i Strategjisë Zhvillimore Lokale 2024-2029

Inxh i dipl. Shkodran Gaxherri -Eksperti 1

Masc: Egzon Binakaj - Eksperti 2

Fotografitë:

Nga arhiva e GLV Gjeravica, Deçani ynë dhe Visit Deçani

Kontribut të çmuar për hartimin e kësaj Strategjie Zhvillimore Lokale 2024-2029, dhanë Paneli i eksperteve lokal të Komunës së Deçanit, Kryetar të Këshillave të fshatit, Shoqatat e grave, bletar dhe grupet e të rinjëve dhe përfaqësues tjerë të zonave rurale